



Shqipëria dhe Italia Forcojnë Aleancën Ushtarake: Fillon epoka e re e bashkëpunimit transadriatik



» faqe 3



RRITJE PAGASH PËR USHTARAKËT NË VITIN 2026, VENGU: VLERËSIM PËR PËRKUSHTIMIN DHE SHËRBIMIN NDAJ ATDHEUT

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, ka bërë të ditur se me Projektbuxhetin e vitit 2026 do të ketë rritje pagash për ushtarakët e Forcave të Armatosura, si pjesë e politikës së qëndrueshme të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës së personelit në uniformë. Sipas ministrit, kjo rritje është...



faqe 2



SHSHPPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI, NË TAKIMIN ME TË DËRGUARËN SPECIALE TË MBRETËRISË SË BASHKUAR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në takimin me të dërguarën speciale të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Dame Karen Pierce, i zhvilluar në bordin e anijes "HMS Richmond" të Forcave ...



faqe 4



ARBEN SKËNDERAJ: MUZIKA DHE KULTURA, FORCA QË BASHKON UNIFORMËN ME SHPIRTIN

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një intervistë ekskluzive për shtypin ushtarak, z. Arben Skënderaj, Drejtor i Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, sjell në vëmendje historinë, rolin dhe rëndësinë e këtij institucioni që prej themelimit të tij në nëntor...



faqe 6



BUXHETI I MBROJTJES 2026: RRITJE HISTORIKE PËR MODERNIZIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA

Ministri Vengu: Ky është buxhet sigurie, zhvillimi dhe krenarie kombëtare

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, prezantoi sot në Komisionin për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes projektbuxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2026, duke e cilësuar atë si më ambiciozin që nga anëtarësimi i Shqipërisë në NATO.

Sipas ministrit, projektbuxheti i vitit të ardhshëm parashikon 58,9 miliard lekë, një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2025. Për herë të parë, buxheti i Mbrojtjes arrin në 2,12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke përmbushur objektivin e përcaktuar nga Aleanca e Atlantikut të Veriut.

Pesë priorite për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare

Ministri Vengu theksoi se buxheti i ri fokusohet në pesë drejtime strategjike, me qëllim forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe modernizimin e Forcave të Armatosura:

- Rritja e dinjitetit të uniformës, përmes shtimit të pagave dhe përmirësimit të benefiteve për personelin ushtarak.
- Forcimi i misionit të FA-së, me investime në kapacitete ushtarake, gatishmëri për emergjenca dhe rritje të rolit të Shqipërisë në NATO.
- Ringritja e industrisë “Made in Albania”, me zhvillimin e mjeteve të blinduara, municioneve dhe sistemeve anti-dron.



- Modernizimi i Emergjencave Civile, përmes krijimit të një flote të re kombëtare dhe ndërtimit të qendrave rajonale të emergjencave.
- Financim i drejtë për zonat me risk të lartë, duke rritur aftësinë reaguese ndaj fatkeqësive natyrore dhe

emergjencave.

“Ky është një buxhet sigurie, zhvillimi dhe krenarie kombëtare”, – u shpreh ministri Vengu, duke theksuar se çdo qindarkë do të investohet në rritjen e aftësive të mbrojtjes dhe të rolit të Shqipërisë në Aleancën e NATO-s.

Rritje pagash për ushtarakët në vitin 2026, Vengu: Vlerësim për përkushtimin dhe shërbimin ndaj atdheut

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, ka bërë të ditur se me Projektbuxhetin e vitit 2026 do të ketë rritje pagash për ushtarakët e Forcave të Armatosura, si pjesë e politikës së qëndrueshme të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës së personelit në uniformë. Sipas ministrit, kjo rritje është një vlerësim i merituar për ata që shërbejnë me përkushtim në mbrojtje të sigurisë dhe sovranitetit të vendit. “Më shumë vlerësim për ata që shërbejnë me përkushtim. Rritja e pagave për ushtarakët në Forcat e Armatosura është pjesë e politikës së qëndrueshme dhe vendimeve të Qeverisë Shqiptare për të garantuar kushte më të mira pune dhe jetese”, – u shpreh ministri Vengu.

Me Projektbuxhetin 2026, pagat përfshijnë rritje që shkon deri në +5,875 lekë, nga Ushtari IV deri te Gjenerallejtënanti, së bashku me shtesa për kushte pune dhe trajtim ushqimor.

Kjo masë vjen si vazhdim i përpjekjeve të qeverisë për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe rritjen e motivimit të efektivëve që kontribuojnë çdo ditë në mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare.



Në një ngjarje historike për marrëdhëniet dypalëshe, u zhvillua në Romë, në Vilën Doria Pamphili, mbledhja e parë e përbashkët e qeverive të Shqipërisë dhe Italisë. Kryeministri Edi Rama u prit me ceremoni zyrtare nga homologia e tij, Giorgia Meloni, në një takim që shënon një moment të ri në bashkëpunimin mes dy vendeve.

Për herë të parë, Italia zhvillon një mbledhje të përbashkët qeveritare me një shtet jo anëtar të Bashkimit Europian, duke nënvizuar rëndësinë që i jep marrëdhënieve me Shqipërinë, fqinjin e saj strategjik në Adriatik.

Kryeministri Rama e cilësoi këtë ngjarje si një “ditë historike për marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë”, duke theksuar se “mbledhja e parë e përbashkët e dy qeverive hap rrugën për 16 marrëveshje të reja konkrete bashkëpunimi, në kuadër të partneritetit të ngushtë strategjik me Italinë”.

Në këtë takim morën pjesë 10 ministra të kabinetit shqiptar, përfshirë: zëvendëskryeministren dhe ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku, ministren e Jashtme Elisa Spiropali, ministren e Drejtësisë Besfort Lamallari, ministren e Brendshme Albana Koçiu, ministren e Mbrojtjes Pirro Vengu, ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Evis Sala, ministren e Ekonomisë dhe Inovacionit Delina Ibrahimaj, ministren e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Blendi Gonxhja, ministren e Mjedisit Sofjan Jaupaj, dhe ministren e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Adea Pirdeni.

16 marrëveshje bashkëpunimi në fusha kyçe

Në fund të mbledhjes, u firmosën 16 marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi që mbulojnë fusha të gjera si:

- Mbrojtja dhe siguria kombëtare
- Energjia dhe infrastruktura
- Mbrojtja civile dhe emergjencat
- Shëndetësia dhe mbrojtja sociale
- Mbrojtja kibernetike dhe inovacioni digjital
- Migracioni dhe bashkëpunimi ekonomik

Një kapitull i ri në partneritetin ushtarak Shqipëri-Itali

Një nga pikat më të rëndësishme të këtij takimi ishte nënshkrimi i marrëveshjes së re të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet ministrit shqiptar të Mbrojtjes, Pirro Vengu, dhe homologut italian Guido Crosetto.

Ministri Vengu deklaroi se “rinovohet pas më shumë se tre dekadash partneriteti ushtarak me Italinë, një hap i rëndësishëm që forcon aleancën tonë brenda NATO-s dhe nxit zhvillimin e industrisë ushtarake shqiptare”.

Sipas tij, nga 16 marrëveshjet e firmosura, 8 i përkasin drejtpërdrejt fushës së mbrojtjes, industrisë ushtarake dhe mbrojtjes civile.

Këto përfshijnë:

- Marrëveshjen mes kompanisë shtetërore shqiptare KAYO dhe gjigantit italian “Fincantieri” për prodhimin e anijeve ushtarake;
- Marrëveshjen mes KAYO-s dhe kompanisë “Leonardo” për zhvillimin e teknologjive ushtarake dhe mbrojtjen kibernetike;
- si dhe marrëveshje për krijimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe përfshirjen e Shqipërisë në numrin europian të emergjencave “112”.

“Ky partneritet shënon një faqe të re në bashkëpunimin tonë transadriatik. Do të forcojmë sigurinë rajonale, do të zhvillojmë kapacitetet tona teknologjike dhe do të sigurojmë një përgjigje të shpejtë në emergjencë”, – theksoi ministri Vengu pas takimit me homologun italian.

Bashkëpunim strategjik dhe vizion europian

Të dy kryeministrat, Rama dhe Meloni, nënvizuan se Shqipëria dhe Italia ndajnë një histori, një miqësi të qëndrueshme dhe një vizion të përbashkët europian.

Sipas tyre, kjo mbledhje shënon fillimin e një kapitulli

Shqipëria dhe Italia Forcojnë Aleancën Ushtarake: Fillon epoka e re e bashkëpunimit transadriatik

Firmosen marrëveshje historike në fushat e mbrojtjes, energjisë, sigurisë dhe zhvillimit ekonomik



të ri të partneritetit strategjik, me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe të sigurisë në të gjithë hapësirën mesdhetare.

“Kemi hyrë në një etapë të re të marrëdhënieve mes dy vendeve tona, me më shumë projekte konkrete dhe me një frymë të thelluar besimi e bashkëpunimi”, – u shpreh Rama në përfundim të mbledhjes.

Një shembull unik bashkëpunimi rajonal
Me zhvillimin e kësaj mbledhjeje të parë ndërqeveritare

dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të reja, Shqipëria dhe Italia konfirmojnë statusin e tyre si partnerë strategjikë të pazëvendësueshëm në Adriatik dhe Mesdhe, duke bërë këtë ngjarje një moment historik për diplomacinë dhe sigurinë e rajonit.

Ky bashkëpunim i ri shënon një “kapërcim epokal” në marrëdhëniet mes dy vendeve, duke forcuar aleancën politike, ekonomike dhe ushtarake Shqipëri-Itali, në përputhje me objektivat e përbashkëta për paqe, siguri dhe integritet europian.



SHSHPFA, Gjenerallejtënant Arben Kingji, në takimin me të dërguarën speciale të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në takim me të dërguarën speciale të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Dame Karen Pierce, i zhvilluar në bordin e anijes “HMS Richmond” të Forcave Detare Britanike, e ankoruar në Porto Romano, Durrës.

Në takim morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, zëvendës shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut, zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe zëvendës shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Bosnje dhe Hercegovinës.

Gjatë diskutimeve, u shkëmbyen pikëpamje mbi forcimin e bashkëpunimit ushtarak ndërmjet vendeve të rajonit, në kuadrin bilateral, rajonal dhe në bashkëpunim të ngushtë me Aleancën e NATO-s.

Gjenerallejtënant Arben Kingji theksoi se bashkëpunimi me Forcat e Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar mbetet një shtyllë e rëndësishme për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

“Kënaqësi të marr pjesë në këtë takim me përfaqësuesit e vendeve të rajonit dhe partnerët tanë britanikë. Ky bashkëpunim është thelbësor për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor”, – u shpreh gjenerallejtënant Arben Kingji.



SHQIPËRIA NGRE KOMPLEKSIN MË TË MADH STËRVITOR PËR FORCAT E ARMATOSURA

Në rajonin e Bizë-Pajetit po ngrihet kompleksi më i madh stërvitor i Forcave të Armatosura, një investim madhor që pritet të akomodojë deri në 1200 trupa dhe të ofrojë kushte bashkëkohore për stërvitjen e personelit.

Ky projekt përbën një hap tjetër konkret në drejtim të modernizimit të infrastrukturës ushtarake dhe forcimit të kapaciteteve stërvitore të ushtrisë shqiptare.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu e cilësoi ndërtimin e kompleksit të ri si “një shndërrim të Bizës në një poligon ndërkombëtar të dedikuar të stërvitjes së Forcave të Armatosura dhe një dëshmi të qartë se investimet për rritjen e gatishmërisë, aftësive dhe standardeve janë prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes”.

Në këtë zonë po ndërtohen ambientet e nevojshme për akomodimin, ushqimin, mbështetjen shëndetësore dhe argëtimin e personelit që do të marrë pjesë në stërvitjet e zhvilluara në kushte dimërore dhe verore. Komandanti i Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë në Forcën Tokësore, Mydeir Tafa, theksoi se “është hera e parë që realizohet një investim i tillë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë”. Ai shtoi se “projekti është konceptuar për të garantuar kapacitete të larta stërvitore dhe akomodimin e një numri të madh efektivash”.

Sipas komandant Tafës, aktualisht janë përfunduar blloku i komandës së batalionit dhe blloku i mensës-kuzhinës me kapacitet për 600 efektivë njëherësh, ndërsa po vijon ndërtimi i ambienteve të tjera të fjetjes dhe mbështetjes logjistike.

Ky investim strategjik do të mundësojë stërvitje komplekse kombëtare e ndërkombëtare, duke e pozicionuar Bizë-Pajetin si një qendër të rëndësishme stërvitore rajonale, në përputhje të plotë me standardet e NATO-s dhe objektivat e Ministrisë së Mbrojtjes për forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.



Kontingjenti XVII EOD në mbështetje të Brigadës Shumëkombëshe Letoneze

Kontingjenti XVII EOD (Eliminimi i Mjeteve Shpërthyesë), në kuadër të misionit të Prezencës së Përparuar Tokësore (Enhanced Forward Presence), realizoi me sukses një sërë detyrash operacionale në mbështetje të Brigadës Shumëkombëshe Letoneze.

Gjatë zhvillimit të misionit, efektivët shqiptarë kanë demonstruar profesionalizëm të lartë, përgatitje teknike dhe disiplinë shembullore, duke bashkëpunuar ngushtë me forcat aleate për çminimin, identifikimin dhe neutralizimin e mjeteve shpërthyesë në terren.

Ky angazhim reflekton përkushtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ndaj paqes, sigurisë dhe vlerave të Aleancës së NATO-s.

Kontributi i trupave tona EOD vazhdon të mbetet një shtyllë e rëndësishme në misionet ndërkombëtare, duke dëshmuar aftësitë dhe besueshmërinë e personelit shqiptar në fushën e operacioneve shumëkombëshe.



Kontingjenti X i Forcës Detare niset drejt operacionit të NATO-s “Sea Guardian” në Detin Egje

Kontingjenti X i Forcës Detare u nis drejt Detit Egje, ku do t'i bashkohet operacionit të NATO-s “Sea Guardian”, një nga misionet detare më të rëndësishme të Aleancës që synon ruajtjen e sigurisë detare dhe mbrojtjen e jetëve njerëzore.

Ky angazhim i Forcës Detare shqiptare dëshmon kontributin e vazhdueshëm dhe të çmuar të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, në kuadër të angazhimeve ndaj Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO).

Në ceremoninë e nisjes, drejtues të Forcës Detare dhe të Shtabit të Përgjithshëm vlerësuan profesionalizmin, përkushtimin dhe gatishmërinë e efektivëve që marrin pjesë në këtë mision, duke u uruar sukses dhe mision të mbarë.

Ky angazhim pasqyron vendosmërinë e Forcave të Armatosura për të qenë një aleat i besueshëm dhe aktiv në operacionet e NATO-s, duke kontribuar për paqen dhe stabilitetin në rajon e më gjerë, u theksua gjatë ceremonisë.



Efektivët e Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut marrin pjesë në stërvitjen ndërkombëtare “Sciabola di Bronzo 25”, në Itali

Efektivë nga Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut morën pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “Sciabola di Bronzo 25”, zhvilluar në bashkëpunim me Regjimentin e 7-të Alpin të Forcave Tokësore Italiane.

Stërvitja kishte si fokus rritjen e aftësive luftarake dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet njësisë, si dhe zhvillimin e operacioneve malore në kushte ekstreme të motit dhe terrenit.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në këtë aktivitet përbën një shprehje të qartë të angazhimit të tyre për të forcuar bashkëpunimin ushtarak me partnerët italianë dhe për të rritur nivelin e përgatitjes profesionale të trupave shqiptare në kuadër të standardeve të NATO-s.

“Mbetemi të përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit ushtarak dhe forcimin e lidhjeve profesionale mes ushtrive të dy vendeve tona”, – u theksua në përfundim të stërvitjes.



Stërvitje dypalëshe mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Ushtrisë Rumune në kuadër të misionit EUFOR “ALTHEA”

Në kuadër të angazhimeve të përbashkëta në operacionin EUFOR “ALTHEA”, personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë zhvilloi një stërvitje dypalëshe me trupat e Ushtrisë Rumune në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

Stërvitja kishte për qëllim forcimin e ndërveprimit dhe koordinimit gjatë misioneve të përbashkëta, me fokus në:

- komunikimin ajër-tokë gjatë operacioneve të përbashkëta;
- procedurat e sigurimit të zonës së uljes (LZ) dhe të imbarkimit (PZ);
- transportin ajror të personelit;
- dhe stërvitjen e ekipeve të reagimit të shpejtë në terren.

Ky aktivitet përforcon bashkëpunimin ndërmjet vendeve aleate, duke rritur gatishmërinë operacionale dhe aftësinë për të vepruar në mënyrë të koordinuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

EUFOR “ALTHEA” mbetet një mision kyç për ruajtjen e paqes dhe stabilitetin në Bosnje-Hercegovinë, ku Shqipëria vazhdon të japë kontributin e saj me profesionalizëm, përkushtim dhe integritet në kuadër të operacioneve shumëkombëshe.



Një trashëgimi që frymëzon – Intervistë me
z. Arben Skënderaj, Drejtor i Qendrës së Kulturës,
Medias dhe Botimeve në Ministrinë e Mbrojtjes

ARBEN SKËNDERAJ:



Muzika dhe kultura,
**forca që bashkon
uniformën me shpirtin**

**Arti është
një mënyrë
e bukur për
t'i shërbyer
atdheut.
Tradita
që kemi
trashëguar
është e pasur,
por ajo ka
nevojë të
ringjallet
në çdo brez
me frymë të
re. Forcat e
Armatosura
nuk janë
vetëm
uniformë dhe
detyrë, por
janë edhe
zemër, shpirt,
ndjenjë. Dhe
këto ndjenja i
mbart arti më
mirë se çdo
gjë tjetër.**



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një intervistë ekskluzive për shtypin ushtarak, z. Arben Skënderaj, Drejtor i Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, sjell në vëmendje historinë, rolin dhe rëndësinë e këtij institucioni që prej themelimit të tij

në nëntor të vitit 1949 e deri në ditët e sotme.

Dikur i njohur me emrin SHQUP, ky institucion ka qenë një vatër e rëndësishme e jetës kulturore dhe artistike të Forcave të Armatosura.

Nën strukturën e tij funksiononin Ansambli i Ushtrisë, Estrada e Ushtarit, Orkestra Frymore, si dhe organizoheshin aktivitete metodike në garnizonin e Tiranës e ndihma metodike në shkallë ushtrie.

Në kulmin e veprimtarisë së tij, qendra numëronte mbi 300 punonjës artistë, mes të cilëve një kor me 60 këngëtarë, një kompleks vokal me 16 anëtarë, një grup vallesh me 12 çifte, orkestra me 33 instrumentistë, 6 solistë dhe një sektor ndihmës me 8 punonjës.

Në vijim, z. Skënderaj ndalet tek momentet më të rëndësishme të historikut të qendrës, kontributi i saj në jetën kulturore të ushtrisë dhe mënyra se si tradita artistike ushtarake po përshtatet me realitetin modern të Forcave të Armatosura.

Z. Skënderaj, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve ka një histori të gjatë që nis që në vitin 1949. Si do ta përshkruanit rrugëtimin e saj nga SHQUP-i i dikurshëm deri te QKMBM-ja e sotme?

Historia e kësaj qendre është, në fakt, historia e shpirtit krijues të ushtrisë shqiptare. Që nga themelimi në nëntor të vitit 1949, SHQUP-i ka qenë një qendër ku arti dhe kultura u ndërthurën me disiplinën dhe përkushtimin ushtarak. Aty u formuan breza të tërë artistësh që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në artin skenik, muzikor dhe koreografik të vendit. Sot, si Qendër e Kulturës, Medias dhe Botimeve, ne kemi ruajtur atë frymë, por e kemi përshtatur me kohën, me teknologjinë dhe me misionin modern të Forcave të Armatosura.

Cili ka qenë roli kryesor i këtij institucioni në formimin kulturor dhe shpirtëror të ushtarakëve ndër vite?

Kultura ka qenë gjithmonë një shtyllë e rëndësishme e moralit ushtarak. Përmes artit, ushtarakët kanë gjetur



mënyra për të shprehur emocione, për të ndërtuar unitet dhe për të forcuar ndjenjën e përkatësisë. Në çdo kohë, aktivitetet tona kanë synuar të krijojnë një klimë pozitive dhe frymë bashkëpunimi mes efektivëve, duke i kujtuar se shërbimi ndaj atdheut nuk është vetëm detyrë, por edhe nder e dashuri.

Në përbërje të qendrës dikur ishin struktura të rëndësishme artistike si Ansambli i Ushtrisë, Estrada e Ushtarit dhe Orkestra Frymore. Si kujtohen këto trupa sot dhe çfarë ndikimi lanë në kulturën shqiptare?

Këto trupa ishin ambasadorë të kulturës shqiptare. Me performancat e tyre në qytete, fshatra, garnizone e madje edhe jashtë vendit, ata mbollën dashurinë për artin e pastër shqiptar. Shumë artistë të njohur kanë nisur rrugëtimin e tyre pikërisht në Ansamblin e Ushtrisë. Sot ne i kujtojmë me respekt, dhe përpiqemi t'i mbajmë gjallë ato tradita përmes festivaleve, ekspozitave dhe projekteve artistike që lidhen me trashëgiminë e tyre.

Si është përshtatur Qendra me kohën dhe me ndryshimet që ka sjellë modernizimi i Forcave të Armatosura?

Transformimi ka qenë i domosdoshëm. Sot kemi një qendër që jo vetëm prodhon veprimtari kulturore, por edhe menaxhon median, botimet dhe komunikimin institucional të Ministrisë së Mbrojtjes. Përdorim teknologjinë moderne në çdo aspekt të punës sonë. Qëllimi është që kultura të mos mbetet në të kaluarën, por të ecë paralelisht me zhvillimin e ushtrisë.

Kontributi i QKMBM-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes në Zhvillimin e Talenteve të Fëmijëve të Ushtarakëve

Cili është roli i QKMBM-së në edukimin, formimin dhe trajnimin e fëmijëve të ushtarakëve?

QKMBM ka si mision kryesor të ofrojë edukim dhe trajnim të plotë për fëmijët e ushtarakëve. Qendra ofron programe kulturore, artistike dhe sportive, duke i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të integrohen në mënyrë aktive në komunitetin ushtarak dhe shoqëror.

Çfarë ofron kjo qendër për fëmijët e ushtarakëve?

Qendra ofron kurse muzike, pikturë, dhe sporte të ndryshme. Gjithashtu, organizon aktivitete kulturore, ekspozita, gara sportive dhe trajnime të specializuara, duke u siguruar që fëmijët të zhvillojnë talentet e tyre në një ambient mbështetës dhe profesional.

Si ka qenë ndihma e Ministrisë së Mbrojtjes për përkrahjen e këtyre talenteve?

Ministria e Mbrojtjes ka mbështetur QKMBM-në, duke siguruar fondet për materiale, mësues dhe trajnerë të specializuar. Ajo gjithashtu sponsorizon pjesëmarrjen e fëmijëve në konkurse dhe aktivitete jashtë vendit, duke i dhënë mundësi të rriten profesionalisht dhe të shfaqin talentet e tyre.

Si ka kontribuar Ministria e Mbrojtjes në zhvillimin e kurseve dhe ngritjen e nivelit të trajnimeve?

Ministria ka ndihmuar në përmirësimin e kurrikulave, trajnimin e stafit dhe pajisjen e qendrës me teknologji moderne. Kjo ka mundësuar që kurset të jenë më të strukturuar, profesionale dhe të përshtatura për zhvillimin maksimal të fëmijëve.

Cilat janë disa nga projektet apo aktivitetet më të rëndësishme që Qendra ka zhvilluar vitet e fundit për të ruajtur dhe promovuar traditën kulturore ushtarake?

Janë shumë, por do veçoja disa që kanë pasur ndikim të madh: rikthimin e ekspozitave me temë ushtarake, publikimin e monografive historike dhe organizimin e koncerteve me temë patriotike në bashkëpunim me ansamble e shkolla arti. Gjithashtu, kemi forcuar rolin e revistës ushtarake dhe mediave tona online, që sot janë platforma serioze për informacion dhe kulturë.

A ka bashkëpunime me institucione të tjera kulturore brenda dhe jashtë vendit, dhe sa ndihmojnë këto në forcimin e imazhit të ushtrisë shqiptare?

Po, dhe kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e punës sonë. Ne bashkëpunojmë me institucione kulturore kombëtare, me Akademinë e Arteve, me arkivat dhe muzeumet e vendit, por edhe me partnerë ndërkombëtarë. Këto bashkëpunime na ndihmojnë të tregojmë fytyrën e vërtetë të ushtrisë shqiptare, një ushtri moderne, humane dhe e lidhur ngushtë me kulturën dhe vlerat kombëtare.

Cili është mesazhi juaj për artistët ushtarakë të rinj dhe për ata që duan të kontribuojnë në trashëgiminë

kulturore të Forcave të Armatosura?

Do t'u thosha të mos ndalen së krijuari. Arti është një mënyrë e bukur për t'i shërbyer atdheut. Tradita që kemi trashëguar është e pasur, por ajo ka nevojë të ringjallet në çdo brez me frymë të re. Forcat e Armatosura nuk janë vetëm uniformë dhe detyrë, por janë edhe zemër, shpirt, ndjenjë. Dhe këto ndjenja i mbart arti më mirë se çdo gjë tjetër.

Biseda me z. Arben Skënderaj sjell një vështrim të çmuar mbi një nga institucionet më me traditë të kulturës ushtarake shqiptare. Nga rrënjët e saj në vitet e pasluftës, deri te roli bashkëkohor në promovimin e vlerave të artit dhe medias në Forcat e Armatosura, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve mbetet një urë lidhëse mes historisë dhe së ardhmes. Falë përkushtimit të stafit dhe mbështetjes institucionale, kjo qendër vazhdon të mbajë gjallë shpirtin krijues të artistëve ushtarakë dhe të promovojë kulturën shqiptare me dinjitet e profesionalizëm. Trashëgimia e dikurshme, tashmë shndërrohet në një frymë të re, atë të një institucioni modern që ruan kujtesën, por edhe ecën me ritmet e kohës.

FALEMINDERIT!



Në buzë të humnerës: Kriza e shëndetit mendor dhe makabritetet që na tronditin çdo ditë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një tjetër tragjedi që na përplasi me realitetin

Makabriteti i radhës u regjistrua sërish. Një tjetër jetë e pafajshme, një tjetër vajzë e mitur, një tjetër histori që të shkëlqen shpirtin. Një “njeri”, nëse mund ta quajmë kështu, që në fakt i ngjan më shumë një përbindëshi të lindur nga errësira e shoqërisë sonë.

Në një kanal, në një cep të harruar, gjendet trupi i saj. I hedhur tutje, si një objekt pa shpirt. Dhe ne, sërish, tronditemi. Shokohemi, zemërohemi, por pas pak ditësh, harrojmë. Pyetja që mbetet është e vetmja që: në ç’ botë jetojmë vallë?

Një shoqëri që po gërryhet nga brenda

Rastet e tilla, për fat të keq, nuk janë më të rralla. Krimet brenda familjes janë kthyer në një plagë të hapur, që rrjedh gjak çdo ditë. Statistikisht, çdo muaj raportohen dhjetëra raste të dhunës, abuzimeve dhe vrasjeve brenda mureve të shtëpisë aty ku duhej të kishte dashuri, ka frikë; aty ku duhej të kishte ngrohtësi, mbretëron terrori. Më tronditëse se shifrat janë vetë historitë: babai që vret vajzën, burri që ther gruan, djali që i merr jetën nënës, vëllai që shkatërron jetën e motrës.

Janë tablo që na shfaqin fytyrën e një shoqërie në krizë të thellë morale dhe mendore.

Shkaqet e errëta pas përbindëshave

Psikologët e sociologët prej kohësh paralajmërojnë: kjo nuk është vetëm krizë sociale apo ekonomike është një krizë e shëndetit mendor kombëtar.

Të dhënat tregojnë se pas shumicës së këtyre ngjarjeve që përfundojnë tragjikisht, qëndron një histori e gjatë dhune, abuzimi, depresioni, ose çrregullimi psiko-emocional që kurrë nuk është trajtuar. Por përtej statistikave, ajo që po ndodh është më e frikshme: po prodhojmë individë të braktisur emocionalisht, që nuk e dinë çfarë është ndjeshmëria, kufiri moral apo përgjegjësia.

Faktorët janë të shumtë:

- Shkatërrimi i strukturës tradicionale familjare, ku respekti dhe mbështetja e ndërsjellë po zëvendësohen nga indiferenca.
- Varfëria dhe papunësia, që kthejnë frustrimin në dhunë.
- Izolimi social dhe mungesa e komunikimit, që krijojnë individë të mbyllur, me botë të sëmurë brenda tyre.
- Stigma e sëmundjeve mendore, që i mban të fshehura plagët deri në shpërthim.



Shëndeti mendor, sëmundja e shekullit XXI

Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi vite më parë se deri në vitin 2050, sëmundjet e shëndetit mendor do të jenë shkaktari kryesor i paaftësisë dhe sëmundjeve globale. Por kjo e ardhme, fatkeqësisht, është tashmë këtu.

Depresioni, ankthi, bipolariteti, psikozat janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë, edhe pse shpesh të padukshme. Shumë njerëz vuajnë në heshtje. Frika e etikimit si “i çmendur” i shtyn të mbyllën në vetvete. Kjo heshtje, si një zjarr i fshehur, shpërthen një ditë në formën e kimit. Dhe atëherë është tepër vonë.

Kur turpi vret

Në kulturën tonë ende mbizotëron turpi ndaj mjekut psikiatër, si të ishte një vullë e turpit e jo një hap drejt shërimit. Shumë familje zgjedhin të fshehin problemet e shëndetit mendor të të afërmeve, duke i mbyllur brenda katër mureve, derisa ndodh tragjedia. Në fakt, në këto raste, heshtja është bashkëfajësi. Përballë një njeriu që ka shenja të dhunës, paranojës, depresionit apo agresivitetit, heshtja e familjes është si të mbash një bombë në duar.

Nevoja për një strategji emergjente kombëtare

Nuk mjaftojnë reagimet emocionale pas çdo tragjedie. Duhet politikë publike, investim dhe ndërgjegjësim real. Sistemi i mjekut të familjes, duhet të rikthehet në vijën e parë të kontaktit me qytetarin. Duhet një census kombëtar i shëndetit mendor, që të identifikojë rastet me rrezik të lartë, të përfshihen psikologë në çdo shkollë, institucion dhe komunitet. Universitetet mjekësore mund të angazhojnë studentët e psikologjisë e psikiatrisë si vullnetarë për depistim dhe ndërgjegjësim, duke krijuar një rrjet ndihme në nivel lokal.

Shoqëria, media dhe rrjetet sociale: Armë ose shpëtim

Roli i mediave është jetik. Nuk mjafton të raportosh krimin, duhet ta shpjegosh, analizosh dhe parandalosh. Ndërsa rrjetet sociale, në vend që të shërbejnë për edukim, shpesh kthehen në platforma talljeje e përbuzjeje ndaj personave me probleme mendore. Ky është një krim tjetër, më i heshtur, por po aq shkatërrimtar. Nevojitet një etikë e re sociale, që të mos i trajtojë njerëzit me probleme mendore si “monstra”, por si pacientë që kanë nevojë për ndihmë.

Një apel për ndërgjegjësim kombëtar

Krimi brenda familjes nuk është vetëm çështje penale, është simptomë e një shoqërie që po humbet ekuilibrin emocional. Nuk ka ligj që mund të parandalojë urrejtjen, nëse ajo ushqehet çdo ditë në zemrat e njerëzve të papërkujdesur. Por mund të ketë sisteme që kujdesen, edukojnë dhe ndërhyjnë në kohë.

Familjet duhet të jenë bashkëpunëtore, jo mbuluese. Shoqëria duhet të jetë edukatore, jo tallëse. Institucionet duhet të jenë vigjilente, jo të heshtura. Vetëm një zinxhir vetëbesimi, koordinimi dhe ndjeshmërie mund të shpëtojë jetë njerëzish. Shëndeti mendor nuk është luks, është themeli i çdo jete njerëzore.

Nga errësira drejt ndërgjegjësimit

Nuk lindim përbindësia, i prodhojmë me heshtje, me dhunë, me mungesë dashurie dhe moskujdes. Nëse duam një shoqëri të shëndetshme, duhet të fillojmë nga rrënjët: nga familja, nga shkolla, nga vetëdija për shëndetin mendor.

Vetëm atëherë mund të shpresojmë që vajzat e nesërme të mos kenë më frikë nga ata që duhet t’i duan, dhe që titujt makabër të mos jenë më lajmi i parë i ditës.



Në altarin e Atdheut: Roli dhe sakrifica e grave kolonjare në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Nga sakrifica në pavdekësi: Gruaja kolonjare në historinë e LANÇ-it

Historia e popullit tonë, gjatë shekujve të gjatë të robërisë, është e mbushur me shembuj të shumë heroizmi të gruas shqiptare. Në çdo periudhë historike, ajo ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut. Kjo është arsyeja pse femra shqiptare zë një vend të veçantë dhe të nderuar në historinë kombëtare, që nga periudha ilire e deri më sot.

Atdhetarizmi i njohur i gruas shqiptare, cilësitë e saj morale dhe shpirtërore, u shfaqën me forcë të re gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ), kur shumë gra e vajza të popullit morën armët dhe luftuan krah për krah me burrat. Pjesëmarrja e gruas në LANÇ ishte një nga risitë më të mëdha të asaj epopeje çlirimtare. Në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare u rreshtuan rreth 6.000 gra dhe vajza, të cilat dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm në luftën kundër nazifashizmit, por edhe kundër zakoneve e paragjyqimeve shekullore.

Edhe gratë kolonjare shkëlqyen për trimërinë dhe përkushtimin e tyre. Ato treguan aftësi të rralla organizimi, drejtimi dhe qëndrese morale, duke u rreshtuar mbi 50 luftëtare në formacionet partizane, pa llogaritur qindra të tjera që punonin në prapavijë për furnizime, përkrahje dhe ndihmë mjekësore.

Në çdo epokë, në çdo faqe të historisë njerëzore, drita e gruas ka ndriçuar si një zjarr i qetë që s'është shuar kurrë. Ajo ka qenë nëna që ka lindur breza, bija që ka ushqyer shpresën, motra që ka qëndruar në krah të burrit në ditë të vështira. Shumë herë pa emër, pa varr, pa lavdi. Por gjithnjë me shpirt të lartë, me një dashuri që buron nga thellësia e tokës e nga fryma e Atdheut.

Edhe gruaja kolonjare, me thjeshtësinë dhe madhështinë e saj, është pjesë e kësaj drite të pashuar. Ajo nuk ka qenë vetëm nënë, bashkëshorte apo motër; ka qenë udhëheqëse e heshtur, bartëse e urtësisë dhe, kur ka qenë nevoja, luftëtare me pushkë në dorë. Historia e Kolonjës është e mbushur me gra që kanë ditur të ruajnë nderin e shtëpisë dhe të mbrojnë lirinë e vendit me gjakun e tyre.

Në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, gruaja shqiptare mori pjesë në mënyrë masive në rezistencën kundër pushtuesve. Ajo u bë organizatore, luftëtare, infermiere, propagandiste dhe udhëheqëse. Në çdo qytet e fshat u krijuan këshillat e grave antifashiste, që organizuan ndihma, trakte, fushata ndërgjegjësimi dhe veprimtari arsimore.

Organizata “Bashkimi i Grave Antifashiste Shqiptare”, e themeluar në vitin 1943, u bë shtylla e rolit të ri të gruas në shoqëri. Në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të Labinotit, delegacioni i grave kërkoi përfshirjen e tyre në Frontin Nacionalçlirimtar — dhe ja arriti.

Krahas luftës, gratë e asaj kohe ngritën edhe organin e parë të shtypit për to — revistën “Gruaja Shqiptare”, që u bë zë i emancipimit dhe i ndërgjegjes kombëtare.

Në betejat e LANÇ-it, shumë gra dhe vajza ranë heroikisht në fushën e nderit. Midis tyre, gjashtë gra dhe vajza kolonjare



u shquan për sakrificën e tyre sublime.

Dritaren e shtëpisë e ktheu në fortifikatë Afërdita Roko Koti (1 shkurt 1924 – 12 nëntor 1943)

Lindi në fshatin Blush të Kolonjës, në një familje atdhetare e arsimdashëse.

Që në vitet 1942–1943 u angazhua si aktiviste e rinisë, duke shpërndarë trakte e ndihmuar lëvizjen antifashiste.

Më 12 nëntor 1943, gjatë përleshjeve të ashpër midis batalionit partizan “Hakmarrje” dhe forcave balliste në fshatin Blush, çdo shtëpi u kthye në pozicion lufte. Afërdita, nga dritarja e shtëpisë, orientonte partizanët, por u diktua dhe u qëllua për vdekje.

U shpall Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 76, datë 12.11.1969 dhe me vendim nr. 7, datë 20.5.2003. Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Ersekës.

Nënkryetarja e gruas që sfidoi ballistët Gliqeri Andrea Ropi (31 dhjetor 1885 – 7 maj 1943)

Lindi në fshatin Leshnjë të Kolonjës, në një familje me tradita atdhetare.

Ishte nënkryetare e organizatës së gruas në fshatin e saj dhe kontribuoi në mbledhjen e ndihmave për partizanët. Aktiviteti i saj ra në sy të forcave të Ballit Kombëtar, të cilat e arrestuan dhe e pushkatuan, më 7 maj 1943, në fshatin Leshnjë.

U shpall Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 52, datë 17.6.2005. Prehet në varrezat e fshatit Leshnjë.

“Trimat janë në mal, jo këtu në shtëpi” Marie Dhimitër Gjergo (24 mars 1895 – 9 nëntor 1943)

Lindi në Gostivisht të Kolonjës, në një familje të njohur për ndjenja patriotike.

Shtëpia e saj u bë bazë e rëndësishme për ilegalët dhe partizanët. Ajo i ndihmonte me ushqime, i mjekonte të plagosurit dhe u bënte roje gjatë mbledhjeve.

Më 8–9 nëntor 1943, kur shtëpia e saj u rrethua nga ballistët që kërkonin të birin partizan, ajo u përball me guxim dhe tha: “Trimat janë në mal, jo këtu në shtëpi”. Për këtë qëndresë u vra mizorisht. U shpall Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 76, datë 12.11.1969. Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Ersekës.

U vra me torbën e bukës për partizanët Eftimi Kosta Kuka (20 prill 1886 – 22 janar 1944)

Lindi në fshatin Radovë të Leskovikut, në një familje patriote.

Gjatë LANÇ-it, shtëpia e saj u bë bazë e qëndrueshme e partizanëve. Nënë Eftimia i ndihmonte me ushqime, veshmbathje e strehim.

Më 22 janar 1944, teksa mbante torbën me bukë për partizanët, u ndesh me forcat gjermano-ballistë dhe u vra mizorisht në vend.

U shpall Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 76, datë 12.11.1969. Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Ersekës.

Ra përgjegjësjë e rinisë në Ersekë

Stathica Thanas Papakristo (2 mars 1928 – 28 nëntor 1944)

Lindi në fshatin Postenan të Leskovikut.

Që në moshë të re u përfshi në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, duke organizuar vajzat për përgatitjen e triko dhe çorapeve për partizanët, shpërndarjen e trakteve dhe mësimin e këngëve patriotike.

Në gusht 1944, mori pjesë në përleshjet kundër forcave gjermano-ballistë në fshatin Radanj, si pjesëtare e çetës territoriale. U arrestua, por u lirua më pas. Pas lirit punoi si përgjegjëse e rinisë në Ersekë, derisa ra aksidentalisht gjatë detyrës, më 28 nëntor 1944.

U shpall Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 76, datë 12.11.1969 dhe me vendim nr. 5, datë 27.12.2002. Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Ersekës.

Me pushkë dhe çantën e infermieres në ballë të luftës Shaniko Iljaz Jupasi (14 nëntor 1927 – 18 tetor 1944)

Lindi në fshatin Starje të Kolonjës, në një familje me tradita atdhetare.

Në vitin 1943, doli partizane në batalionin “Hakmarrje”, më pas në Brigadën X Sulmuese. U dallua për guxim, dashuri për shokët dhe përkushtim. Përveç pushkës, mbante gjithnjë çantën e infermieres, duke u kujdesur për të plagosurit në vijën e parë të luftës.

Ra heroikisht më 18 tetor 1944, gjatë luftimeve në Fikas të Elbasanit, kundër një autokolone gjermane.

U shpall Dëshmore e Atdheut me vendim nr. 76, datë 12.11.1969 dhe me vendim nr. 7, datë 12.11.2002. Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Ersekës.

Nderim dhe mirënjohje të përjetshme

Gratë dhe vajzat kolonjare, ashtu si shumë të tjera në mbarë Shqipërinë, u bënë shembull i pathyeshëm trimërie, qëndrese dhe përkushtimi për lirinë e atdheut. LANÇ-i i ngriti për herë të parë në piedestal, duke i bërë pjesë të pavdekshme të historisë sonë kombëtare.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Lufta e Mendimit dhe Mendimi mbi Luftën: Filozofia e Gjeneral Pëllumb Qazimit

Për librat e rinj dhe jo vetëm, latinët kanë lënë një shprehje të pakontestueshme nëpër shekuj se, “Habent sua fata libelli/ Librat kanë fatin e tyre”. Kështu edhe dy librat e gjeneral Pëllumb Qazimit janë një qasje e re dhe një mendim profesionist në tregun e librave të sigurisë dhe mbrojtjes. Pas librit të tij të parë “Histori e ushtrisë shqiptare: 1912-1991”, që realisht ishte një sukses i plotë pasi ka pasur një konsulencë të gjerë shkencore si dhe një “usta” të kalibrit ndërkombëtar, sikurse ishte mentori dhe udhëheqësi shkencor, një kolos i mendimit albanolog Aleksandar Stipčević ilirolog, historian, arkeolog dhe studiues arbëresho-kroat.

Autori i librit i ngjiti shkallët e karrierës ushtarake në mënyrë të “ngeshme”, me besim dhe vendosmëri. Pëllumb Qazimin nuk e zgjodhën, por e përzgjodhën për të drejtuar nivelet më të larta të lidershit ushtarak, për aftësi dhe erudicion, intelektual ushtarak profesionist, që u rrit dhe formua me bazë “zbulues” në akademitë më të mira ushtarake të vendit, por edhe në shkollat dhe akademitë e perëndimit si dhe ato diplomatike.

Ky formim dhe vështrim i realiteteve e shtroi dhe e përqasi aty ku e ka vendin në fakt në anën e studiuesve të historisë ushtarake, të doktrinave dhe strategjive, të luftës dhe të vështrimit mbi historinë e shqiptarëve. Ambasador Ditmir Bushati, ish-ministër i Punëve të Jashtme, në parathënien e librit më të fundit të Dr. Gjeneral dhe Ambasador Pëllumb Qazimit, “Lufta dhe Shqiptarët”, e klasifikon si kontribues dhe një nga personalitetet më të shquara të fushës së sigurisë dhe diplomacisë, që ka sjellë për lexuesin, “analizë në mënyrë shteruese të raportit të luftës me ne, shqiptarët, duke i qëndruar fort argumentit se kombi shqiptar asnjëherë nuk ka qenë komb agresor, por nga ana tjetër, vendi ynë ka qenë arenë lufte apo fushëbeteje për palë të tjera ndërluftuese”.

“Lufta dhe shqiptarët” jo një libër për stoli bibliotekash

Pak ditë më parë, shtëpia botuese “M&B” ka publikuar librin më të ri të gjeneral Pëllumb Qazimit, që vjen në këtë libër pas shumë viteve të vrullshme dhe më të pjekura në fushën e mendimit ushtarak, por dhe diplomatik që nuk mund të shikohen të shkëputura nga mendimi dhe shkencat e tjera të studimit.

Fati i këtij libri është i parashkruar, sepse



aparati konceptual i librit, ka sjellë atë me çfarë janë “ushqyer” shekujve, jo vetëm shqiptarët por mbarë planeti ynë, u ka folur shekujve më shumë për histori luftërash se sa paqe, apo për histori ekonomike. Lufta, kjo shkencë dhe art i shkatërrimit të njerëzimit ka prekur sipas analistëve e historianëve, në rreth 5500 vitet e fundit, vetëm 300 vite kanë qenë paqe. Pjesa tjetër është vetëm Luftë, dhe ky ka qenë shqetësimi dhe motivi për të shkruar pikërisht këtë libër për luftën, këtë fantazmë

Nga Fusha e Betejës te Diplomacia: Trashëgimia e Gjeneral Pëllumb Qazimit

Promovimet e librave janë promovime vlerash, pasi filozofi i madh i botës Sokrati thoshte: “Ka vetëm një të mirë në jetë dhe ajo është Dituria”. Dituria e një jete njerëzore e depozituar në trurin intelektual, në “arkivin lëvizës”, natyrshëm shkruhet, tregohet e publikohet, për një jetë intensive dhe të dinjitetshme. Ushtaraku madhor, ambasadori, intelektual Pëllumb Qazimi po jep një shembull të mirë duke shkruar dy vëllimet e para: “Histori e ushtrisë shqiptare: 1912-1991” dhe libri më të ri “Lufta dhe shqiptarët”. Gjeneralletënant dhe Ambasador Pëllumb Xhafer Qazimi, është vlerësuar me dhjetëra dekorata dhe urdhra ushtarakë, me titullin “Qytetar Nderi i Skraparit”, por dhe nga SHBA-të me Medaljen “Legjioni i Meritës”.



shfarosëse, që shqiptarëve u ka mbirë në prag nga lindja dhe nga perëndimi. Autori Qazimi vjen në këtë libër me një ndjenjë sigurie për të thënë fjalën e vet për të shkruar shqiptarë në dymbëdhjetë krerë. Më konkretisht përmes mendimeve të koncentruara flet për: “Lufta”, “Shqipëria në paleoluftën”, “Tre zhvillime të luftës së ftohtë”, “Arsye të mosdukjes së Shqipërisë”, “Kombi shqiptar, jo komb agresor”, “Paleolufta dhe neolufta, të përbashkëta dhe dallime”, “Domosdoshmëria e Forcave të Armatosura”, “Zhgënjimi ndaj ushtrisë”, “Diplomacia dhe roli i saj”, “Transformimi ushtarak, proces i vijueshëm”; ku përveç krerëve të plotë në 318 faqe, libri përmban edhe aparat shkencor të pasur me 194 libra e literaturë ku dominon literatura në gjuhë të huaj. Libri përmban hyrje, parathënie të një diplomati të spikatur shqiptar të shkruara nga këndvështrimi i një diplomati karriere, një hyrje të sinqertë të kohës që jetoi në kohën e paqes së kërcënuar, duke sjellë definicione rreth “paleoluftës, luftës së ftohtë dhe neoluftës”, si dhe mjaft material të pasur që meritojnë vëmendjen e studiuesve dhe sidomos historianëve ushtarakë.

Depërtimi në misteret e historisë së luftërave të shqiptarëve

Gjeneral Pëllumb Qazimi si njohës edhe i figurave të albanologjisë dhe gjuhëtarisë dhe ia

vlen të sjellim një shprehje të Eqrem Çabej, kur flitet për luftërat / “grindjet”: “Shqipëria është trualli në të cilin grindja e gjatë ndërmjet botës romane-perëndimore dhe ballkanike-bizantine, është shprehur në mënyrën më të spikatur... ky qëndrim i ndërmjetmë midis Perëndimit e Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë, që nuk mundi ta fshijë as sundimi romak, as bizantin dhe as osman... Shqipëria ka qenë e orientuar më tepër nga Perëndimi sesa nga fqinjët e saj”.

Kjo përputhet me konkluzionet e autorit dhe këndvështrimin e tij për luftën dhe iliro-arbërorë-shqiptarët. Nga ana tjetër kjo përkon edhe me atë që thotë poeti i madh i rilindjes sonë kombëtare Naim Frashëri se: “Zhvillimi i Shqipërisë i përket modeleve socio-kulturore perëndimore”. Objekti i studimit të gjeneral Qazimit lidhet, me mbijetesën shqiptare gjatë shekujve, edhe përballë furive të makinerive luftarake nga më të rëndat e pushtimeve, u kanë mbijetuar planeve djallëzore, platformave Naçertanie dhe Megaliidea, mbijetesën përballë Traktatit të Shën Stefanit, Berlinit, Londrës, Parisit etj. Ndërkohë që për luftërat e shqiptarëve vlen të citohe fjalët e arta të Çabej, “si në kohën antike, edhe më vonë, ky popull malësor i fortë jep gjakun e tij për mbrojtjen e kombeve të reja ballkanike, jo vetëm me anë të përzjerjes etnike, por edhe në

pikëpamje politike, si kasta luftëtare me armë në dorë”, por edhe më tej ka qenë kasta luftëtare e mbarë Evropës me stradiotët e shquar shqiptarë.

Analiza e luftërave për shqiptarët e sjellë nga Pëllumb Qazimi është për miqtë, për “vëllezërit e gjakut”, për kundërshtarët e shekujve, për diplomacinë shqiptare të mbi një shekulli, për sakrificat e panumërta në luftë dhe në paqe, për orekset e shtuara e deri tek “vrasjet e orkestruara të shqiptarëve”, sikurse ishte ekzekutimi i mbi 3500 shqiptarëve në Masakrën e Tivarit që meriton rishqyrtim dhe analizë serioze bazuar në dokumente.

Në këtë drejtim vëmendje merr veprimtaria anti-andarte më 1913-1914, por dhe viti 1940, edhe lufta e parë dhe e dytë botërore, viti i sulmeve të monarko-fashistëve fqinjë jugorë, më 1949, ligji i luftës, lufta 9-vjeçare e dëbrave, lufta e Koplikut, por dhe mjaft incidente mbi trupin e Shqipërisë në periudha komplekse historike.

Gjeneral Qazimi përmes studimit ka njohur miqtë dhe armiqtë në Ballkan dhe jo vetëm, në pikëpamje të kapaciteteve të makinerive të tyre luftarake, por dhe nga aspekti i formatit politik, ekonomik, social, diplomatik, gjeopolitik etj. Autori na jep një panoramë të gjerë e të larmishme mbi momentet kyçe, ku përshkruhet e kaluara, rrugëtimi historik i ngritjes së shtetit, por dhe për periudhat epokale të shkatërrimit, kur kombi shqiptar nuk ka qenë kurrë një komb agresor; ndërkohë që pasqyrohet edhe lidhshmëria me traditën, të drejtën zakonore, kodifikimet dhe përmbajtja e tyre, kur flitet për “rregullat e jetës dhe të vdekjes”, për të dhënë konsideracione të shumta mbi të djeshmen shqiptare. Ai ka sjellë të skalitur në muret e kujtesës sonë historike një prurje të re me vlerë që i shërben jo vetëm frymës patriotike, intelektualizmit por mbarë shqiptarizmit.

Shifra dhe fakte nga historia shqiptare: “Pa të shkruar nuk ka të ardhme”

Të flasësh për shifra e fakte duhet të depërtosh thellë në arkiva, të njohësh të djeshmen e kombit dhe të hedhësh vështrimin edhe në të ardhmen e tij. Në libër gjenden me shumicë “shifra e fakte”, që meritojnë edhe studiues të tjerë që të pasurojnë historinë tonë edhe me të dhëna të tjera më të bollshme arkivore, ndërkohë që tashmë rrugët e arkivistikës brenda dhe jashtë janë bërë edhe më të lira. Ato janë në fakt edhe më të hapura. Më vështirë në këtë fushë është të punosh me arkivat e fqinjëve veriorë dhe jugorë ndërkohë që për arkivat e tjera në botë flitet gjerësisht dhe rrugët në fakt janë “autostradë”. Prandaj edhe maksima proverbiale spanjolle thotë se “...rrugët janë bërë duke ecur”.

Autori Qazimi ndalet në librin e tij edhe tek aleancat, dje dhe sot, tek luftërat hibride, tek armiq të njohur dhe të panjohur, tek teknologjia e re e luftës, tek aktorët e faktorit, tek kompleksiteti, sjell raste nga përtej rajonit, nga konfliktet dhe ligji i konfliktit të armatosur, nga Bosnja dhe Kosova, nga teatrot e luftës, paqeruajtësit e paqë-bërësit. Gjeneral Qazimi sjell fakte reale por dhe definicione nga kolosë të mendimit sikurse janë Makiaveli, Karl Fon Klauzevici, Kolin Pauelli, Samuel Hantingtoni, Ajzehauer, të rajonit, të Evropës dhe të mbarë planetit, veçanërisht të SHBA-së. Një ndër vitet më të vështira shqiptare ishte 1997-a, vit i mbrapshtë që e sollën vetë shqiptarët dhe e çuan shtetin në buzë të greminës. Koshient për këtë gjëmë shqiptare vijne edhe mendimet e gjeneral Qazimit, por pasiguria politike e shoqëruar me shkatërrimin e ushtrisë, 600 mijë armë të lehta dhe automatike, 200 mijë pushkë, një milionë mina, 38 mijë pistoleta..., 770 gryka zjarri, 560 milionë fishekë, 3 milionë granata... një arsenal që lidhet me 1300 depo ushtarake. Shifrat nuk kanë të sosur dhe mbi të gjitha ishte një pasuri

e çmuar e shqiptarëve. Kjo jo vetëm kërkon analizë të thellë por dhe përgjegjshmëri. Politika duhet të japë llogari në radhë të parë para popullit. Dje, sot dhe nesër vetëm interesat tona kombëtare janë të trashëgueshme historikisht. Ndjenja e devocionit daton thellë në histori dhe i ka rrënjët tek frymëzimi dhe pasioni atdhetar me rrënjë iliro-arbërore, që ka në thelb shqiptarizmen.

Shpresat e fikura të shqiptarëve i ndezi që në shekullin e XV Gjergj Kastrioti në motin e madh të Arbrit dhe më tej Rilindasit e mëdhenj, idealistët e Kombit për të mbërritur në shekullin XX, ku pavarësia shqiptare ishte fryt i vetë shqiptarëve dhe i miqve ndërkombëtarë, edhe pse të paktë ishin për t’u nderuar e respektuar, duke shprehur mirënjohje. E megjithatë kombi shqiptar do të ecë dhe përparojë me dituri dhe vetëm me dituri.

Nuk është e rastit që gjeneral Qazimi i mëshon intelektualizmit dhe progresit, pasi edhe fatet e këtij libri i ka projektuar në cilësinë e mendimit dhe produktiviteten që e bën lexuesin të vëmendshëm ndaj ngjarjeve më madhore të kombit. Gjeneral Qazimi i apasionuar që në rini pas leximit, kishte përvetësuar ndër të tjera edhe artin e lënë nga filozofët e mëdhenj sikurse ishte Sokrati, që thoshte në mënyrë kaq të spikatur: “Ka vetëm një të mirë: “Dituria” dhe ka vetëm një të keqe “Padituria”. Prandaj si erudit i ndriçuar me dituri dhe i apasionuar për të qenë në avantgardë të grupit shoqëror që i përkiste u bë udhërrëfyes dhe këto i ka dokumentuar me vepra. I tillë është edhe libri që sapo ka parë dritën e botimit, si një libër me vlerë.

Autori ndjek edhe zhvillimet aktuale të politikanëve botërorë që po e çojnë njerëzimin në

djersë e pasion për librat, që e shikon librin si thesar të çmuar, duke pasuruar botën e brendshme të njeriut, veçanërisht për të kultivuar edhe më tej vlerat e dijes, kulturës dhe qytetarisë, edhe si kontribut i fuqishëm në kulturën kombëtare ushtarake shqiptare. Autori Qazimi ka një të shkuar të suksesshme dhe ka shumë për të treguar nga shkolla “Skënderbej” dhe më tej Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve dhe më vonë edhe Akademia e Shtabit të Përgjithshëm. Autori është produkt i shkollës, trupës pedagogjike dhe komanduese, vetë-disiplinimit. Rreshti, kapanoni, “çohu”, “shpejt”, “tranazh”, “rekrut”, “gati-tu” kanë qenë për ushtarakët sinonim i jetës, si dhe formimi i gjithanshëm lidhej me “Shkollën e burrërimin” të parakohshëm.

Pëllumb Qazimi ka qenë student i Shkollës së Bashkuar, por që arriti shpejt të bëhej elitari në studime dhe më tej një oficer i talentuar dhe oficer i përkushtuar i ushtrisë popullore. Në atë periudhë kur në bankat e shkollës ishte Pëllumb Qazimi, meritokracia nuk kishte nevojë as për miq dhe as për shokë e mbi të gjitha nuk pranonte “furka”, për t’u mbajtur në këmbë. Ose do të ecje me këmbët e tua ose do rrëzoheshe dhe do të “thyeje kokën”. Me tempin e një studiuesi të apasionuar, gjeneral Qazimi vijoi gjithë trajnimet dhe kualifikimet, për t’ia mbërritur në publikimin e librave-vlerë sikurse është edhe libri i tij më i ri “Lufta dhe shqiptarët”. Autori Qazimi pulson me jetën qytetare shqiptare, shqetësohet për instrumentet e sigurisë sot, për çështjet e sigurisë që nuk mund të nënkontraktohen, për mbrojtjen e sovranitetit që kërkon jo vetëm ushtarë dhe buxhet mbrojtjeje që “kafshon” rëndë buxhetin e shtetit, si dhe diplomaci si faktor shumëfishues i sigurisë kombëtare.

Pëllumb Qazimi për 34 vite (1972-2006) ka qenë nën uniformë dhe me karrierë të gjatë drejtimi ushtarak, por dhe për 16 vjet si Ambasador i Shqipërisë në Kroaci e Slloveni, me fuqinë e intelektit dhe analizuesit historik ka sjellë një udhërrëfyes mbi pikëpamjet ushtarake, diplomatike, të ekspertizës në çështjet e sigurisë, vështrime përreth rajonit e më gjerë në historinë dhe politikëbërjen, mbi diplomacinë e kulisave dhe mbi të gjitha mbi “lesson learned”, mbi ndryshimet e tashme dhe të pritshme në ambientin gjeopolitik, mbi vizionin e së ardhmes shqiptare, mbi sjelljet e qëndrimit politike e diplomatike, përballimin e sfidave dhe përmushjes së pritshmërisë së publikut. Fakt është që vizionarët kanë qenë dhe kanë mbetur të rrallë, politikëbërësit janë të shumtë, por ne kemi vetëm një Atdhe, në këtë botë globale kaq të paqëndrueshme. “Lufta dhe shqiptarët”, i autorit Pëllumb Qazimi me recezentë të Ditimir Bushatin dhe Marenglen Kasmin, vjen për lexuesin nën redaktimin plot elegancë të botuesit të shtëpisë botuese “Naimi”, të redaktorit Naim Zoto, ashtu si dhe publikimet e njohura të kësaj shtëpie botuese. Një pjesëmarrje masive në Pallatin e Kongreseve mbloodhi promovimi i librit më të fundit të Pëllumb Qazimit “Lufta dhe shqiptarët” (më datën 7.11.2025), ku u fol gjerësisht për luftërat që shqiptarët kanë përballuar shekujve të historisë. Libri është një udhërrëfyes i domosdoshëm, jo vetëm për lexuesit e thjeshtë e të pasionuar pas historisë së luftërave, por edhe për ushtarakët, diplomatët, ekspertët e çështjeve të sigurisë dhe politikëbërësit shqiptarë.

Rrënjët stërgjyshërore dhe një karrierë sinjifikative e Gjeneral Pëllumb Qazimit

Pëllumb Qazimi është lindur, më 21.10.1957, në fshatin Çepan të Skraparit. Ai erdhi në jetë në një familje të Skraparit, një trevë e njohur me ngjarje e kontribute në historinë tonë kombëtare. Pëllumbi lindi “rastësisht” në Çepan, pasi babai i tij, Xhaferi, ishte me shërbim si oficer kufiri në Sarandë dhe së bashku me nënën e Pëllumbit, Florian dhe djalin e madh, ndodheshin me disa ditë pushime në Çepan. Kështu, Pëllumbi, fëmijë i vogël, qëndroi rreth tre muaj në Çepan dhe mandej së bashku me prindërit dhe vëllain e madh shkuan në Zminec të Sarandës, ku babai i tij shërbente si oficer kufiri. Bazuar në të dhënat dokumentare, por dhe burimet gojore, të parët e fisit Qazimi të sotshëm, flitet se janë vendosur në Çepan të Skraparit rreth viteve 1820-1825. Gjyshërit Sali dhe Karafila kanë qenë njerëz fjalëpakë, por punëtorë të ndershmë dhe të sakrificës. Familja e madhe është marrë me bujqësi, blegtori, si edhe me ndërtimtari. Gjyshi, ashtu si bashkëfshatarë të tij, gjatë viteve 1943-1944, ka ndihmuar partizanët përmes transportit të ushqeimeve e municioneve.

Të njëjtën gjë, pavarësisht se ishte vetëm 13-14 vjeç, ka bërë edhe babai i Pëllumbit, Xhaferi. Familja e madhe e gjyshit, Saliut, krahas punës për

të mbajtur familjen dhe pavarësisht pamundësive është shquar edhe për dëshirën që fëmijët të arsimohen sa më shumë. Pëllumb Qazimi është pjesë e një familje ushtarakësh. Babai, vëllai i madh dhe motra e madhe, kanë shërbyer në radhët e ushtrisë. Po ashtu edhe një nga xhaxhallarët dhe të afërm të tjerë. Edhe pse u lind në Çepan, Pëllumb Qazimi në fshatin e origjinës së prindërve shkante vetëm gjatë pushimeve të verës. Pesë vitet e para Pëllumbi i kaloi në fshatin Zminec të Sarandës dhe mandej deri në moshën 15 vjeç në Llongo të Dropullit të Sipërm dhe mandej në qytetin e Gjirokastrës.

Lëvizja lidhej me detyrat që kryente babai si ushtarak, të cilat kanë ndikuar edhe në arsimin e Pëllumbit. Kështu arsimimin fillor e kreu në vitet 1964 – 1968 në gjuhën greke, në shkollën fillore të Llovinës, Dropulli i Sipërm, ndërsa shkollën 8-vjeçare e kreu po në gjuhën greke në shkollën tetëvjeçare në Llongo të Dropullit të Sipërm, Gjirokastrë. Më tej vijoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë (1.9.1972-30.7.1976), shkollë që e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Të sillel në vëmendje se Pëllumbi në Shkollën “Skënderbej” njihej si skënderbegas Pëllumbi Fodulli, pasi “Fodulli” ishte mbiemri i familjes së madhe deri atëherë dhe në ato vite mbiemri ishte ndryshuar në “Qazimi”. Në moshën 20-vjeçare, më 1.1.1977 deri më 30.7.1980, vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, në specialitetin “Zbulim”. Në vitin 1981 titullohet oficer dhe shërbeu në ish-shkollën e zbulimit të ushtrisë si komandant toge dhe instruktor stërvitjeje. Pas përfundimit të Akademisë së Mbrojtjes, në vitin 1991, u emërua instruktor i zbulimit me trupa në Drejtorinë e Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm. Në vitet në vijim ai është emëruar shef i degës së zbulimit me trupa në Drejtorinë e Zbulimit, zëvendës drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Informativ Ushtarak dhe shef i Zbulimit Ushtarak, për të mbërritur deri në detyrën madhore dhe shumë të përgjegjshme të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, në dy mandate, në periudhën shtator 2000 – tetor 2006.

Në vitin 1992, kapiteni I Pëllumb Qazimi, me urdhër të kryeministrit u ngarkua me detyrën e kryetarit të komisionit ndërministror për refugjatët, detyrë që e ushtroi për 6 vite rresht dhe që lidhej me përgatitjen e vendit për pritjen e refugjatëve në rast të një konflikti të mundshëm në Kosovë. Gjatë krizës së vitit 1997, me ardhjen e trupave ndërkombëtare për vendosjen e qetësisë në vend, pala shqiptare organizoi një strukturë të veçantë, e cila koordinonte e bashkëpunonte me shtabin drejtues të operacionit “Alba” dhe kolonel Pëllumb Qazimi u emërua zëvendëskomandant për palën shqiptare. Pëllumb Qazimi nuk është vetëm një ushtarak i spikatur dhe një profesionist i diplomacisë por edhe një studiues serioz i letrave, veçanërisht i fushës së mendimit ushtarak e diplomatik. Ai është autor i një vargu studimesh dhe artikujsh në shtypin ushtarak shqiptar e të NATO-s dhe i kumtesave të mbajtura në veprimtari shkencore brenda e jashtë Shqipërisë. Ai ka qenë anëtar i Redaksisë së Fushës së Zbulimit dhe të Ushtrive të Huaja të FEUSH-it. Me vullnet dhe këmbëngulje arriti që të mbrojë doktoraturën në periudhën kur ka qenë ambasador në Kroaci dhe që është inkurajuar e këshilluar nga një kolos i mendimit, ilirologu dhe albanologu Aleksandar Stipčević (ilirolog, historian, arkeolog dhe studiues arbëresho-kroat), si edhe nga albanologu i njohur Zef Mirdita. Pëllumb Qazimi ka publikuar: “Histori e ushtrisë shqiptare: 1912-1991”, që është një vepër tërësore, ku autori Qazimi i ka bërë një paraqitje të gjallë të historisë së ushtrisë sonë.

Së fundi gjeneral Pëllumb Qazimi ka sjellë librin e tij më të ri “Lufta dhe shqiptarët”. Natyrshëm planet publikuese do të vijnë, pasi lexuesi ushtarak dhe diplomat do të donin edhe më shumë për përvojën, si dhe mendimin ushtarak dhe diplomatik të Pëllumb Qazimit. Është fakt se ushtaraku madhor Gjenerallejtnant Pëllumb Qazimi është një figurë e dashur ushtarake dhe diplomatike e jo vetëm nga strukturat e mbrojtjes dhe diplomacisë, por edhe më gjerë. Gjatë karrierës së gjatë ushtarake nuk punoi kurrë për dekorata dhe vlerësime, por ato janë të natyrshme dhe të domosdoshme për një forcë ushtarake serioze dhe për më tepër anëtare e organizatës më të madhe të sigurisë në botë, NATO-s. Mban dekorata të larta të shërbimit ushtarak dhe më gjerë. Në nëntor 2024, Gjenerallejtnant dhe Ambasador Pëllumb Qazimi, është vlerësuar me titullin “Qytetar Nderi i Skraparit”, nga Këshilli Bashkiak i Skraparit.

Nga skeda e dosjes gradimet e gjeneral Qazimit e kanë fillueshën me gradën ‘kapiten I’ (urdh.nr.110 dt.27.11.1991), mandej ‘major’ (8.12.1992), ‘nënkolonel’ (7.7.1993) dhe ‘kolonel’ (17.1.1995). Me marrjen e gradës ‘gjeneral brigade’, më 14 shtator 2000, disa ditë më pas ai, me dekret të Presidentit të Republikës, u emërua ‘shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura’, duke marrë gjatë asaj

periudhe trevjeçare edhe gradën ‘gjeneralmajor’ (14.11.2001). Në shtator të vitit 2003, Pëllumb Qazimit me dekret të Presidentit të Republikës iu dha mandati i dytë si shef i Shtabit të Përgjithshëm, përfshi edhe gradën ‘gjenerallejtnant’ (me dekret nr.3952 dt.30.9.2003). Gjeneral Pëllumb Qazim është i martuar me Fatbardha Qazimin dhe kanë tre fëmijë, dy djem Irisi dhe Albi si dhe një vajzë Alisia.

Arsimimi i gjeneral Qazimit: 1964-1968, ka përfunduar shkollën fillore në gjuhën greke në Llovinë, Dropulli i Sipërm, Gjirokastrë; 1968-1972, ka përfunduar shkollën tetëvjeçare në Llongo, Dropulli i Sipërm, Gjirokastrë; 1972-1996 ka përfunduar shkollat ushtarake në Tiranë: Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, në vitin 1976; Shkolla e Bashkuar e Oficerëve-Akademia Ushtarake në vitin 1980, është diplomuar në vitin 1981; Akademia e Mbrojtjes në vitin 1991; Kolegji i Mbrojtjes në vitin 1996; 1999-2000 përfunduar studimet pasuniversitare për siguri globale-diplomaci e mbrojtjes në Kolegjin Ushtarak Mbretëror, Universiteti Cranfield, Mbretëri e Bashkuar; 2001 ka fituar nivelin master “Msc”, në gjuhën angleze, për temën “Studim për bashkekzistencën në Kosovë në krahësim me raste të tjerë”, Kolegji Ushtarak Mbretëror, Universiteti Cranfield, Mbretëri e Bashkuar; 2012 Doktor i Shkencave, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Zagrebit, mbrojtur në gjuhën angleze për tezën “Historia ushtarake shqiptare dhe influencat e huaja, 1912-1991”.

Trajnime dhe kualifikime: Në vitin 1992 ka ndjekur kursin ndërkombëtar për “Refugjatët”, Hungari; Në vitin 1993 ka ndjekur kursin për “Ligjshmërinë Ndërkombëtare për Refugjatët”, Itali; Në vitin 1994 ka ndjekur kursin për “Orientimin dhe planëzimin e operacioneve”, Turqi; Në 1995 ka ndjekur kursin tre mujor “Zbulimi Strategjik”, SHBA; Në 1996 ka ndjekur kursin e NATO-s “Oficer shtabi për operacionet”, Holandë; Në vitin 1998 ka ndjekur kursin për “Ligjin e Luftës”, Itali; Në vitin 2018 ka ndjekur kursin katër-mujor të diplomacisë ekonomike për Shqipërinë, Qendra për Zhvillim Ndërkombëtar, Universiteti i Harvardit, SHBA. Publikime, etj.: 2002-2023, publikime në revista e botime shqiptare dhe të huaja, kontribute në seminare dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit; 2007, bashkautor i studimit: “Këndvështrim nga Shqipëria-Studim për vlerësimin e kërcënimeve të sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor”; 2012, autor i librit në gjuhën angleze “Albania, the Military and the Foreign Influence, 1912-1991”, botuar në Zagreb; Libri i përkthyer e botuar në gjuhën kroate në Zagreb, në vitin 2013 me titull “ALBANIA – vojska i strani utjecaji 1912. – 1991.”; Libri i botuar në gjuhën shqipe në Tiranë, në vitin 2013, me titull “Histori e Ushtrisë Shqiptare 1912-1991”, ribotuar me të njëjtin titull në vitin 2024; libri i botuar në gjuhën shqipe në vitin 2025, me titull “Lufta dhe Shqiptarët”; përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe i librit të autorit slloven Peter Stoka, botuar në vitin 2024, me titull “Shqiptarët e Lashtë dhe Krijimi i Istrias”; Ligjërata në konferenca e institucione të ndryshme në Shqipëri, Gjermani, Kroaci, Maqedoni e Veriut, Slloveni dhe Kosovë.

Pëllumb Qazimi ka pasur një karrierë ushtarake mjaft të suksesshme. Kështu në 1980-2000 ka kryer detyra të ndryshme në Ushtrinë shqiptare; 1992, Kryetar i Komisionit Ndërministror për Refugjatët; Shtator 2000 - tetor 2006 (gjeneral brigade, gjeneralmajor, gjenerallejtnant), Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë; Dhjetor 2006, konsulent për sigurinë në Institutin për Demokraci e Ndërmjetësim (IDN), Tiranë dhe kryetar i bordit botues të Revistës “Çështje të Sigurisë - Security Issues”, botim i IDN; Gusht 2007-2014 ambasador i Shqipërisë në Kroaci; 2008-2010 ambasador i Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë (jo rezident); 2014-2023 ambasador i Shqipërisë në Slloveni. Gjeneral Qazimi nuk punoi kurrë për dekorata, medalje e urdhra. Ndërkohë që në këtë periudhë gjeneral Qazimi e vendosi “me kokë lart” problematikën e vlerësimit me urdhër për dekorimet, ndërkohë që është vlerësuar me këto: Medalje e Punës (urdh.5152 dt.28.2.1974) nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, dy Medalje të Shërbimit Ushtarak, Medalje e Mirënjohjes, Medalje e Artë e Shqiponjës, Medalje e Karrierës, dy Medalje të Shërbimeve të Shquara, Medalja e Urdhrit të Skënderbeut, Medalja e Legjionit të Meritës (SHBA) si dhe Urdhri i Dukës Branimir (Kroaci). Pëllumb Qazimi është një njohës i shkëlqyer i gjuhëve anglisht dhe greqisht.

Burimet e studimit: Dosja personale “Gjenerallejtnant Pëllumb Qazimi” në QPR, MM, Tiranë; FEUSH, Prishtinë, 2020, faqe 734; Kujtim Halili, Fjalor Biografik Ushtarak, Tiranë, SHb Emal, 2006, faqe 141, Zaho Golemi, Kush e ka drejtuar SHP, Ilmi S. Qazimi, Çepani, Monografi, 2015, perioidike të gazetave të përditshme, “Telegraf”, “Panorama”, “Sot”, Revista “Mbrojtja”, Gazeta “Ushtria”, publikime në dy dekada; Të dhëna arkivore AQFA, Buletini Arkivor Ushtarak, etj.



një rrugë pa krye, ndërkohë që vetë dobësimi i marrëdhënieve euro-atlantike nuk është një ogur i mirë për Ballkanin Perëndimor, ku SHBA-të shihen si garant të perimetrit të sigurisë. Përdorimi i forcës demonstronhet pa kriter në botën e sotme dhe zjarrvënësit kanë qenë gjithmonë “hazër-xhevap”, duke qenë larg paqe-bërjes dhe paqeruajtësve, duke injoruar parimet e pallatit të qelqtë njujorkez. Çdo ditë, kur lexojmë vepra me vlerë që të ngelen në mendje, një maksimë e përbotshme na kujton Johann Wolfgang von Goethe, kolosin e mendjes, shpirtit, penës, sintezë e veprës, dritës që bekon deri në frymën e fundit: “Dritë, më shumë dritë”. Kjo dritë është një llambë e ndezur për dritë për gjithë studiuesit. Për paralele historike e tillë është vepra plot dritë nga historia jonë, që shkruan gjeneral Qazimi, një vepër që ndriçon epokat luftarake të shqiptarëve. Autori ka synuar dhe ia ka arritur, që në librin e tij të bëjë përpjekje madhore për ta ndriçuar jetën dhe dimensionet luftarake të shqiptarëve. Librat për gjeneral Qazimin nuk shërbejnë si një stoli intelektuale dhe as për të zbukuruar bibliotekat. Ato janë pasuri që duhen lexuar për të zbukuruar mendjen njerëzore.

Libri ka qenë dhe ka mbetur bashkudhëtar i Gjeneral Pëllumb Qazimit, në një udhëtim të gjatë ushtarak, në një botë me shumë të panjohura, por ai diti të eci në imagjinatën e tij, me këmbëngulje e dashuri për profesionin, duke i dhënë shpresë e dritë ditëve të vështira të shërbimit nën armë, duke përzënë monotoninë dhe mërzinë dhe duke e mbushur jetën me pasuri e trashëgimi intelektuale dhe për më tepër në vitet fundit i dha edhe dimension nga fusha e diplomacisë.

Maksima proverbiale popullore shqiptare që thotë “pa të shkuar nuk ka të ardhme”, është tashmë e vërtetuar, edhe pse historiani dhe analisti ushtarak dhe diplomatik nuk mund të jetë as shenjt dhe as hyjnor, por trashëgues i mençurisë të kultivuar në dekada, fryt i një të shkuare plot



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Historia e njerëzimit është në thelb një histori konfliktesh. Që nga përplasjet e qytetërimeve të lashta deri te luftërat botërore dhe përplasjet ideologjike të shekullit XX, lufta ka qenë një forcë formëuese e shoqërive, ideologjive dhe strukturave politike. Edhe pse shpesh shihet si tragjedi, në kuptimin historik lufta ka qenë një agent transformimi ajo ka shembur perandori, ka lindur shtete, ka përsheptuar zhvillimin teknologjik dhe ka riformësuar rendin ndërkombëtar.

Luftërat që kanë pasur ndikimin më të thellë dhe të qëndrueshëm në formimin e botës moderne nga luftërat romake e deri te Lufta e Ftohtë, duke shqyrtuar ndikimin e tyre politik, ekonomik, kulturor dhe teknologjik:



Luftërat e lashta: Themeli i qytetërimit perëndimor

Luftërat greko-persiane (shek. V p.e.s.) përfaqësojnë momentin kur Greqia e lashtë mbrojti jo vetëm territorin, por edhe identitetin kulturor e politik të qytetërimit perëndimor. Fitorja e Athinës dhe Spartës ndaj Persisë ruajti parimet e demokracisë, filozofisë dhe racionalizmit grek, duke ndikuar më vonë në modelin politik të Evropës. Po kështu, lufta e Peloponezit (431–404 p.e.s.) tregoi dobësitë e një sistemi demokratik në konflikt, duke paraprirë rënien e Greqisë dhe ngritjen e Maqedonisë së Aleksandrit të Madh, që përhapri kulturën helenike në Azi e Afrikë.

Ndërkaq, luftërat romake dhe zgjerimi i Perandorisë Romake përbëjnë gurin themeltar të rendit ligjor, politik dhe administrativ të botës perëndimore. Roma krijoi modelin e parë të globalizimit antik, ku nën një rend të vetëm juridik bashkëjetonin popuj e kultura të ndryshme. Me rënien e Perandorisë Romake (476 e.s.), u krijua ndarja ndërmjet Lindjes Bizantine dhe Perëndimit mesjetar, duke përcaktuar për shekuj vijat e zhvillimit kulturor të Evropës.



Kryqëzatat dhe formimi i identitetit evropian

Kryqëzatat (1095–1291) ishin më shumë se fushata ushtarake fetare. Ato përfaqësuan kontaktin dhe përplasjen e dy qytetërimeve të mëdha: islamit dhe krishterimit. Pasojat e tyre ishin të shumfishta: hapja e rrugëve tregtare me Lindjen, përhapja e dijes arabe në Evropë (astronomi, mjekësi, matematikë), dhe lindja e një identiteti të përbashkët evropian si “botë e krishterë”. Në këtë kuptim, kryqëzatat janë pararendëse të Rilindjes, duke e nxitur Evropën të hapet ndaj dijes dhe botës së jashtme.

Luftërat që formësuan botën moderne: Nga Perandoritë e lashta tek rendi global bashkëkohor



Lufta 100-vjeçare dhe lindja e shteteve kombëtare

Konflikti midis Anglisë dhe Francës (1337–1453) shënoi kalimin nga feudalizmi në monarkitë qendrore kombëtare. Pasojat e saj politike dhe shoqërore ishin të thella: Franca doli e bashkuar nën një pushtet të fortë mbretëror, ndërsa Anglia, pasi humbi zotërimet në kontinent, u përqendrua në zhvillimin e brendshëm dhe detar, duke u shndërruar më vonë në fuqi koloniale.

Në këtë periudhë lindin për herë të parë ndjenjat kombëtare, që do të bëhen boshti i ideologjisë moderne evropiane.



Luftërat Napoleonike dhe Revolucioni i shteteve moderne

Luftërat e Napoleonit (1799–1815) shpërndanë në gjithë Evropën parimet e Revolucionit Francez – lirinë, barazinë para ligjit, meritokracinë dhe kodin civil. Këto luftëra shkatërruan mbetjet e feudalizmit, frymëzuan lëvizje kombëtare në Gjermani dhe Itali dhe hodhën themelet e shteteve moderne evropiane. Pas rënies së Napoleonit, Kongresi i Vjenës (1815) përpiqet të rivendosë ekuilibrin, por fryma revolucionare tashmë ishte përhapur: Evropa nuk do të ishte më kurrë ajo e vjetër.



Lufta e Parë Botërore: Fundi i Perandorive

Lufta e Parë Botërore (1914–1918) është pika e kthesës nga epoka e perandorive në atë të shteteve-komb. Katër perandori të mëdha – Austro-Hungareze, Osmane, Gjermane dhe Ruse – u shembën, duke lindur një hartë të re politike në Evropë dhe Ballkan.

Kjo luftë solli modernizimin e luftës: tanke, aviacion, armë kimike dhe mobilizim total të popullsisë. Por mbi të gjitha, ajo krijoi trauma kolektive që ushqyen ekstremizmin politik dhe përgatitën terrenin për Luftën e Dytë Botërore.



Lufta e Dytë Botërore: Rendi i ri global

Lufta e Dytë Botërore (1939–1945) është ngjarja më përcaktuese e shekullit XX. Ajo shkatërroi Evropën, solli përdorimin e armës bërthamore dhe rikonfiguroi rendin global. Nga hiri i saj lindën dy superfuqi: Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, që ndanë botën në dy blloqe ideologjike – kapitaliste dhe komuniste. Pas luftës, u themelua Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) për të ruajtur paqen ndërkombëtare, ndërsa në Evropë nisi procesi i integrimit që çoi më vonë në Bashkimin Evropian. Po ashtu, kjo periudhë shënoi fillimin e dekolonizimit, ku shumë vende të Azisë dhe Afrikës fituan pavarësinë.



Lufta e Ftohtë: Epoka e teknologjisë dhe globalizimit

Pas vitit 1945, bota u përfshi në një konflikt të ri, Luftën e Ftohtë (1947–1991) midis SHBA-së dhe BRSS-së. Edhe pse pa përplasje të drejtpërdrejtë midis superfuqive, kjo periudhë solli garën bërthamore, hapësirë dhe teknologjike që përshpejtoi zhvillimin shkencor.

Lufta e Ftohtë ndikoi gjithashtu në formimin e aleancave politike e ushtarake (NATO, Traktati i Varshavës) dhe përfundoi me rënien e Murit të Berlinit më 1989, duke i dhënë fund ndarjes ideologjike të botës dhe duke hapur epokën e globalizimit.

- Në retrospektivë, pesë luftëra kanë qenë themelore në ndërtimin e botës moderne:
- Luftërat Romake – që vendosën themelet e rendit ligjor dhe administrativ perëndimor;
- Luftërat Napoleonike – që përhapën idetë e barazisë dhe krijuan shtetet moderne;
- Lufta e Parë Botërore – që shkatërroi perandoritë dhe ndryshoi kufijtë politikë;
- Lufta e Dytë Botërore – që krijoi rendin global bipolar dhe institucionet ndërkombëtare;
- Lufta e Ftohtë – që solli epokën teknologjike dhe fillimin e globalizimit.

Këto përplasje, ndonëse shkatërrimtare, kanë qenë njëkohësisht motori i evolucionit politik, ekonomik dhe teknologjik të njerëzimit. Historia e luftërave është, në thelb, historia e përpjekjeve njerëzore për pushtet, drejtësi dhe rend. Kuptimi i tyre është thelbësor për të kuptuar jo vetëm të kaluarën, por edhe sfidat e së ardhmes.

Referenca historike

- Herodoti, *Historiae*, shek. V p.e.s.
Tukididi, *Lufta e Peloponezit*, shek. IV p.e.s.
Edward Gibbon, *The Decline and Fall of the Roman Empire*, 1776.
Georges Duby, *Le temps des cathédrales*, 1976.
Eric Hobsbawm, *The Age of Revolution* (1962), *The Age of Empire* (1987).
Margaret MacMillan, *The War That Ended Peace* (2013).
Antony Beevor, *The Second World War*, 2012.
John Lewis Gaddis, *The Cold War: A New History*, 2005.



KOLONEL (R) SALI ONUZI

Nga Fusha e Betejës te Paqja: 11 Nëntori dhe Miqësia Shqiptaro-Amerikane

Siç është e njohur gjerësisht në Shqipëri, më 11 nëntor, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kujtojnë, nderojnë dhe festojnë Ditën e Veteranit të Luftës. Ajo është një ditë e shënuar e sanksionuar me ligj, është ditë pushimi zyrtar, dhe ditë aktiviteteve të larmishme shtetërore dhe publike. Ajo tregon qartë se ç’ vlerësim të lartë kanë shteti dhe populli amerikan për Veteranët e Luftës.

Kjo ditë ka dhe një histori të rëndësishme: 11 nëntori është dita e përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Prandaj kjo ditë e shënuar e fitores u kujtua në fillim, më 1919, si ditë e armëpushimit dhe në vitin 1954, me një dekret të Presidentit, ajo u emërtua përfundimisht “Dita e Veteranit të Luftës”. Ajo është Ditë e veteranëve të të gjithë luftërave që janë zhvilluar në SHBA ose kanë zhvilluar ato nga Lufta për Pavarësi (lufta revolucionare amerikane 1775-1783),

Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, deri në luftërat e ditëve të sotme.

Në këto luftëra kanë marrë pjesë disa milionë ushtarë, oficerë amerikanë e punonjës civil, burra dhe gra të të gjithë kombësive që përbëjnë SHBA-të. Në SHBA, veteran është një person që ka shërbyer në Forcat e Armatosura. Sipas një informacioni të 14 prillit 2025, në SHBA kishte 15.8 milionë veteranë të luftës e të ushtrisë. Gratë përbëjnë 11.6 për qind të tyre. Gratë kanë shërbyer për më shumë se dyqind vjet në ushtrinë amerikane. Të gjithë veteranët e Luftës e të Ushtrisë nderohen në këtë ditë. Që nga Presidenti i SHBA-ve, qeveria, Kongresi, dhe shtetet e federuara, Forcat e Armatosura, universitetet dhe shkollat, planifikojnë dhe zhvillojnë veprimtari përkujtimore, homazhe, koncerte, lojëra sportive, ekspozita e deri ulje çmimesh etj. Ajo përkujtohet me nderim të madh edhe nga trupat amerikane që ndodhen aktualisht në shërbim të lirisë e të paqes jashtë vendit të tyre.

Veteranët e Luftës në SHBA kanë pasur gjithmonë një status të lartë në shtetin dhe shoqërinë amerikane. Ky status i ka fillimet e tij historike që më 1865, kur presidenti Lincoln bëri thirrjen e famshme për t’i trajtuar mirë Veteranët e Luftës. Ky status, i përcaktuar me ligje të veçanta për veteranët e çdo lufte, përfshin si vlerësimin e lartë moral të tyre, aspektin juridik dhe atë social-ekonomik e kulturor, si për ata që janë gjallë, por edhe për pasardhësit e veteranëve të rënë në luftë. Ky ligj u jep ushtarakëve amerikanë mbështetje ligjore dhe përfitime të caktuara. Si për shumë aspekte të tjera të jetës shoqërore e politike, ligji amerikan për veteranët e Luftës ka qenë dhe është një model, të cilit i janë drejtuar shtetet dhe vendet demokratike perëndimore. Pas rënies së sistemit monist në Europën Lindore statusi i veteranit të Luftës u bë edhe këtu objekt i ligjvënësve dhe realitet.

11 nëntori përkujtohet si Ditë e Kujtimit edhe në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Komonuelthit Britanik, me 1 minutë heshtje në orën 11:00, ose duke mbajtur një lule të kuqe ose të bardhë në jakë.

Vende të tjera demokratike kanë ditë të tjera për të përkujtuar e nderuar veteranët e Luftës ose të rënë e tyre në Luftëra.

Shqiptarët i lidh me këtë datë së pari roli i madh që kanë luajtur Shtetet e Bashkuara dhe veteranët e tyre në rojë të lirisë dhe të paqes në shekuj, dekada e vite. Por na lidhin edhe qindra djem e vajza shqiptare e me origjinë shqiptare, që si qytetarë të këtij vendi të madh, kanë qenë efektiv të Ushtrisë Amerikane në luftëra, sidomos në Luftën e Parë dhe të dytë Botërore dhe mbi të gjitha në luftën për Çlirimin e Kosovës. Është tanimë aq e njohur dhe simbolike pilotja amerikane me origjinë shqiptare Faruza Haki Kallaba që mori pjesë në bombardimet 78-ditore në Serbi, uniforma ushtarake e së cilës ndodhet sot në një Muze të Kosovës.



Takimi i Spiro Moisiut, ish-komandant i UNÇ me Thomas Eftim Stefanin

Apo dhe shembulli i një batalioni vullnetarësh të shqiptarëve të Amerikës me emërtimin “Atlantik”, që erdhi nga përtej Oqeanit dhe u fut në luftime si pjesë përbërëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ato ishin vazhdim i përvojës dhe traditës së shqiptarëve të Amerikës, të cilët erdhën për të luftuar në Shqipëri pas fitores së Pavarësisë. Na

11 Nëntori, Dita e Veteranëve: Amerika nderon heronjtë, Shqipëria kujton miqtë e saj



lidh edhe kontributi i 13 oficerëve të misioneve amerikane në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Simbol i kësaj lidhje u bë kapiteni Tomas Stefani, djalë i një shqiptari nga Korça, që kish ndërprerë studimet universitare dhe erdhi si shef i ndërëlidhjes amerikane pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare. I bukur, i zgjuar, me një shqipe të qartë, Tomas Stefani u mirëprit edhe nga partizanët e thjeshtë shqiptarë. Për shkak të lidhjes me udhëheqësit e Ushtrisë NÇ, (Enver Hoxha disa herë e mbante afër vetes në mbledhje) ngjalli edhe xhelozinë e oficerëve britanikë në Shqipëri. Tomas Stefani mori pjesë edhe në Kongresin e Përmetit, punimet e të cilit i ndoqi me vëmendje dhe për të cilat hartoi një raport, me të cilin fitoi shumë pikë në Shtabin aleat në Kajro (siç dihet britanikët, me një akt kontravers, nuk iu përgjigjën ftesës së Këshillit ANÇ shqiptar për të marrë pjesë në këtë Kongres të madh antifashist nacionalçlirimtar). Madje Tomas Stefani u martua edhe me një shqiptare të Tiranës që e mori me vete në SHBA.

Na lidh gjithashtu kontributi i pilotëve amerikanë të Aviacionit aleat që realizuan në territorin shqiptar disa sulme kundër forcave gjermane, kundër autokolonave dhe garnizoneve të fortifikuara si në Tiranë e Dibër, ose ai pilotëve të avionëve “Dakota” që sillnin furnizime në Shqipëri për Luftën.

Me veteranët amerikanë na lidhi edhe shpëtimi në Shqipëri i 30 ushtarakëve amerikanë të mjekësisë (nëntor 1943- 9 janar 1944), të cilët ranë aksidentalisht në Çestije të Elbasanit dhe për 68 ditë nëpër Shqipëri nga Berati në Skrapar, në Korçë, në Përmet e Gjirokastër kaluan në bregdetin e Vlorës, ku në gjirin e Gjongjilekës u imbarkuan në një anije britanike për në Bari.

Kudo grupi i amerikanëve qe pritur dhe ndihmuar miqësisht, duke sakrifikuar e vënë edhe jetën në rrezik (gjermanët i kërkonin dhe digjinin shtëpitë që i kishin strehuar). Për ta ishte njoftuar Presidenti amerikan Ruzvelt që kish urdhëruar të gjendeshin dhe shpëtoheshin për më tepër që 13 prej tyre ishin vajza infermiere ushtarake me gradë nëntogere. Për këtë rast, komandanti amerikan i Lindjes së Afërme, gjenerali R. Roi shkroi një telegram falënderimi për popullin shqiptar.



Faruza Haki Kallaba, pilote amerikane me baba shqiptar

Me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit, “Dritare TV”, me producente Rudina Xhungën, realizoi dokumentarin “Në besë të shqiptarëve”, kushtuar pikërisht shpëtimit të grupit të ushtarakëve amerikanë në Shqipëri, përrurimi i të cilit u bë në Kryeministri në prani të kryeministrit Rama, ish-Presidentit Moisiu, ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu, përfaqësuesve të Ambasadës amerikane, pjesëtarëve të familjeve që pritën, strehuan e shpëtuan grupin e ushtarakëve amerikanë dhe plot të ftuar.

Odiseja e tyre drejt lirisë në Shqipëri është bërë pas lufte objekt e subjekt i medias, i letërsisë, kinematografisë, botimeve, vlerësimeve të larta. Disa prej tyre prehen në varrezat kombëtare në Arlington. Me popullin shqiptar veteranët amerikanë të luftës i lidh

përjetësisht kontributi i tyre i madh në Çlirimin e Kosovës që nga gjenerali i madh Wesli Clark, nga diplomati trim Willian Worker te pilotët dhe ushtarakët që u angazhuan kundër ushtrisë pushtuese serbe. Ushtarakët e SHBA-ve edhe sot janë efektivë të KFOR-iz në Kosovë në bazën e tyre të madhe “Bonsfild”. Siç janë të pranishëm në Shqipëri në stërvitjet e NATO-s.

Edhe në Shqipëri e Kosovë vitet e fundit festohet Dita e Veteranit të Luftës Nacionalçlirimtare (në Shqipëri) dhe e Veteranit të Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë. Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2019, caktoi datën 20 korrik si Ditë të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, (datë e krijimit të Organizatës së Veteranëve të Luftës, më 1957), kurse në Kosovë kjo ditë është caktuar më 30 dhjetor, si dita e 30 dhjetorit 1991, të ndeshjes e të fitores së parë të Adem Jasharit kundër forcave serbe.

Më parë në Shqipëri, pas Çlirimit, për 47 vjet (1945-1992) gjithë populli dhe shteti përkujtonin e nderonin veteranët e Luftës dhe të Ushtrisë, më 10 korrik, e përcaktuar atëherë si dita e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe e Ushtrisë Popullore.

Dy nga Veteranët e Luftës së Dytë Botërore që kanë luftuar në Shqipëri (Agnes Jensen Marhgarich dhe Lloyd Smith) kanë qenë në vitet 1995-1996 për vizita, janë pritur në Ministrinë e Mbrojtjes dhe janë takuar e kanë biseduar me veteranë të Luftës, madje kanë vizituar edhe vendet ku kishin qenë në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Mikpritja e tyre ka qenë tipike shqiptare. Agnes Jensen, 83 vjeçe, u thoshte vajzës dhe djalit të saj që e shoqëronin, se “Shqipëria është atdheu im i dytë”. Menjëherë pas vizitës këtu, ajo botoi në SHBA kujtimet e saj për kohën e Luftës në Shqipëri. E ftuar nga Sekretari amerikan i Mbrojtjes, William Perry, në 50-vjetorin e Planit “Marshall” ajo ishte mrekulluar kur Sekretari i përmend emrin e saj si Veterane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe si një Veterane e Luftës së Popullit shqiptar, dhe i tregonte sallës, që duartrokiste, Librezën e Nderit të Veteranes së Luftës Nacionalçlirimtare që i kishte akorduar Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë.

Një përmbledhje e kujtimeve të Agnes Jensen për “aventurën shqiptare” është përfshirë në një botim prestigjioz amerikan, ku janë botuar kujtimet e heronjve të mëdhenj të SHBA-ve në Luftën e Dytë Botërore, së pari të Presidentit George Bush, ish-pilotit Hero të kësaj Lufte.

Ndërsa Lloyd Smith, ish-kapiten i zbulimit amerikan në Himarë, më 1943-1944, në njërin nga shtëpitë e kohës së luftës tregoi se aty i kishte shkrehur pa dashje në tavan një armë që ia kish dhënë për ta parë i zoti i saj. “Po, - i tha mikpritësi shqiptar, - ja tek është vrima e plumbit”. E kishin ruajtur për 52 vjet. Atëherë Smith ngrihet në këmbë e përqafton të zotin e shtëpisë i për malluar. Kur u kthye në Tiranë thoshte se tani u binda që më keni çuar tamam në shtëpitë ku kam qenë në kohë të luftës.

Dua të kujtoj edhe vizitën e delegacionit të Departamentit të SHBA-ve për Çështjet e veteranëve të Luftës (ajo është një ministri si gjithë ministrinë e tjera të kabinetit me një buxhet kolosal) në vendin tonë. Ata kishin kaluar në gjithë vendet e Europës lindore për të dhënë përvojën e tyre për veteranët e Luftës. Të prirë nga drejtoresha e Uashingtonit ata u pritën në Ministrinë e Mbrojtjes, ku u njohën me ligjin për Statusin e veteranit të Luftës dhe me praktikatat e procedurat për dhënien e tij. Që ato ditë u vendosen lidhje të rregullta me Departamentin e SHBA-ve për Çështjet e Veteranëve të Luftës.

Me këtë ditë të shënuar të 11 nëntorit, Veteranët e Luftës ANÇ të popullit shqiptar dhe pasardhësit e tyre, po edhe gjithë populli shqiptar, kujtojnë me respekt Veteranët Amerikanë të Luftës dhe kontributin e madh të tyre për SHBA-të e Botën dhe veçanërisht për Shqipërinë e Kosovën dhe iu urojnë atyre jetë të gjatë e shëndet!

FILIP RRUMBULLAKU, NJË JETË NË SHËRBIM TË VLERAVE

*Filip Rrumbullaku,
Skënderbegasi model!*

Pas përfundimit me rezultate të shkëlqyera të shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej”, ai ndoqi me sukses studimet në “Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë”, dega gjuhë-letërsi, të cilat i përfundoi në vitin 1971. Në të njëjtin vit nisi punën si redaktor në gazetën e Ushtrisë “Luftëtari”, duke dëshmuar talent, përkushtim dhe integritet profesional.

Rruga e tij vazhdoi për 15 vjet në revistën ushtarako-politike “Mbrojtja”, fillimisht si sekretar i kolegjiut dhe më pas, dy vite më vonë, si kryeredaktor i saj. Me lirimin nga Forcat e Armatosura në vitin 1993, ai vijoi punën në sektorin privat deri në vitin 2002.

Nga viti 2002 deri në vitin 2007, Filipi u emërua Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit të Republikës, një detyrë të cilën e ushtroi me dinjitet, përpikëri dhe ndershmërinë që e karakterizonte gjithnjë.

Ai la pas një krijimtari të pasur me shkrime e botime, ndër to së fundmi studime me vlerë mbi shtetësinë shqiptare, të bazuara në arkiva të panjohura, duke trajtuar problematikat ligjore dhe praktikatat institucionale që prej fillesave të shtetit shqiptar e deri sot.

Megjithëse u përball me një sëmundje të rëndë, ai luftoi me forcë, i mbështetur nga familja e tij e dashur, vajzat, bashkëshortja, miqtë dhe shoqëria.

Më 13 nëntor 2025, Filipi u nda nga jeta, duke lënë pas dhimbje të madhe, por edhe kujtime të paharruara për njeriun fisnik që ai ishte.

Lamtumirë! Udhëtim të bardhë mes engjëjsh i nderuar!

Redaksia e shtypit ushtarak shpreh ngushëllimet e singerta për familjen Rrumbullaku për këtë humbje të rëndë. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!



RRUGA E TIJ VAZHDOI PËR 15 VJET NË REVISTËN USHTARAKO-POLITIKE “MBROJTJA”, FILLIMISHT SI SEKRETAR I KOLEGJIUMIT DHE MË PAS, DY VITE MË VONË, SI KRYEREDAKTOR I SAJ. ME LIRIMIN NGA FORCAT E ARMATOSURA NË VITIN 1993, AI VIJOI PUNËN NË SEKTORIN PRIVAT DERI NË VITIN 2002.

Truri i njeriut si motor i superkompjuterëve të së ardhmes

Studiuesit po eksperimentojnë me kultivimin e qelizave të trurit të njeriut në laboratorë, me synimin për t'i shndërruar ato në qarqe biologjike që mund të fuqizojnë superkompjuterët e së ardhmes, një fushë premtuese e njohur si “biokompjuterimi”. Edhe pse kjo ide mund të tingëllojë si e ardhur nga bota e fantashkencës, ekipe të vogla kërkuesish po arrijnë përparime të qëndrueshme.

Revista ndërkombëtare “Nature” i ka kushtuar një artikull të veçantë këtyre përpjekjeve novatore, duke vënë në qendër të vëmendjes shkencëtarët që po përpiqen të ndërtojnë superkompjuterë të bazuar në qeliza të trurit të njeriut.

Një nga pionierët në këtë fushë është “FinalSpark”, një startup bioteknologjik me seli në Visp të Zvicrës. Kompania po zhvillon një “njësi përpunimi biologjike” të ndërtuar mbi organoidet nervore, struktura të ngjashme me trurin, të krijuara përmes kultivimit tredimensional të qelizave burimore njerëzore.

Kohët e fundit, kompania ka arritur të lidhë 16 organoidë – struktura të vogla të ngjashme me trurin – për të ndërtuar një kompjuter biologjik me konsum të ulët energjie. Në terma të thjeshtë, ata po eksperimentojnë me grupe neuronesh artificiale, të zhvilluara nga qeliza njerëzore, për t'i përdorur si njësi përpunimi të ngjashme me kompjuterët tradicionalë.

Studiuesit komunikojnë me këto organoide përmes sinjaleve elektrike, duke simuluar procesin klasik “hyrje → përpunim → dalje”, ashtu si në qarqet kompjuterike. Në ekranet e kompjuterëve shfaqen grafikë në kohë reale që ngjajnë me valët e trurit, duke ilustruar mënyrën se si këto struktura biologjike shkëmbejnë sinjale dhe përpunojnë informacionin.


Edhe pse sistemi nuk ka arritur ende nivelin për t'u cilësuar si “kompjuter” i plotë, “FinalSpark” ka bërë përparime të rëndësishme. Kompania deklaroi: “Kemi zgjatur jetëgjatësinë e organoideve deri në katër muaj dhe po ofrojmë akses online për studiuesit në mbarë botën që të kryejnë eksperimente”. Synimi kryesor është të eksplorohej potenciali i neuroneve për të ndërtuar inteligjencë artificiale të gjeneratës së ardhshme, me konsum energjie jashtëzakonisht të ulët.

Studiuesit që merren me kompjuterët biologjikë përdorin termin “wetware”, një formë e re e “hardware-it të gjallë”, e përbërë nga inde biologjike. Më konkretisht, wetware i referohet sistemeve kompjuterike të ndërtuara nga qeliza të trurit të njeriut.

Ndryshe nga kompjuterët tradicionalë që funksionojnë me çipa silikonit dhe qarqe elektronike, wetware është një sistem organik që imiton trurin e gjallë. Ai ruan dhe përpunon informacionin përmes sinjaleve elektrike që qelizat nervore shkëmbejnë mes tyre, duke mundësuar mësimin, përshtatjen dhe rilidhjen e rrjeteve nervore – ashtu si ndodh në trurin e njeriut.

Ky koncept, i lindur fillimisht në letërsinë fantastiko-shkencore, është përqafuar sot nga komuniteti shkencor për të përshkruar kapacitetet llogaritëse të organizmave të gjallë.

Teknologjia “wetware” po gjen zbatim konkret në fusha si ndërfaqet tru-kompjuter (BCI), për shembull në kontrollin e gjymtyrëve robotikë përmes sinjaleve të trurit, apo në rikthimin e ndjeshmërisë të pacientët me dëmtime nervore. Edhe pse



Kultivimi i qelizave të trurit të njeriut në një laborator dhe shndërrimi i tyre në qarqe biologjike për të krijuar një kompjuter quhet Bio Computing. Fotografia ilustron këtë koncept

ndërtimi i superkompjuterëve të bazuar në organoidet e trurit të rritur në laborator është ende në fazat fillestare, kërkimet po përparojnë në mbarë botën.

Një shembull i fundit vjen nga bashkëpunimi mes FinalSpark dhe Universitetit të Bristolit, ku u testua aftësia e organoideve për të dalluar modele të ndryshme të stimulimit elektrik.

Në eksperiment, studiuesit integruan një sensor të ndjeshëm në një gisht robotik për të lexuar shkronjat braille. Informacioni i lexuar u konvertua në sinjale elektrike dhe u transmetua në tetë elektroda të vendosura në sipërfaqen e organoidit. Neuronet brenda organoidit reagon duke identifikuar me sukses shkronjat braille, duke shfaqur modele të qëndrueshme për secilin sinjal specifik.

Sipas ekipit hulumtues, “saktësia ishte rreth 61% me një organoid, por u rrit në 83% kur u përdorën tre”. Ky rezultat tregon se, edhe në një fazë bazike, organoidet nervore janë të afta të përpunojnë dhe të diferencojnë informacionin në mënyrë efektive.

Profesorja Alison Muotri nga Universiteti i Kalifornisë në San Diego (UC San Diego) është një nga studiueset që po eksploron përdorimin e qelizave të trurit në fushën e inteligjencës artificiale. Së fundmi, ajo ka krijuar organoidë të trurit duke përdorur 250 grupime neuronesh artificiale. Këta organoidë po trajnohen për të parashikuar përhapjen e derdhjeve të naftës në pyjet tropikale të Amazonës, duke përkthyer të dhënat mjedisore në sinjale elektrike. Ky përbën një nga

aplikimet e para të llogaritjes biologjike në sfida industriale. “Jemi ende në fazën e testimit, - tha Muotri, - por synojmë të ndajmë rezultatet brenda tre viteve”.

Ndërkohë, startup-i australian “Cortical Labs” po zhvillon kompjuterë biologjikë duke integruar organoidet e trurit, të rritura nga qeliza burimore njerëzore, në çipa gjysmëpërçues. Në vitin 2022, ata trajnuan me sukses këto qeliza për të luajtur lojën klasike Pong. Këtë vit, ata prezantuan CL1 – kompjuterin e parë biologjik komercial në botë. Edhe pse ende nuk është në gjendje të kryejë llogaritje të ndërlikuara si një kompjuter tradicional, teknologjia po përparon dhe është tashmë e aksesueshme për studiues dhe biznese përmes internetit.

Në SHBA, kompania novatore “Koniku Kore” po zhvillon pajisje hibride që kombinojnë neuronet artificiale me teknologjinë e gjysmëpërçuesve. Në këto pajisje, neuronet funksionojnë si sensorë të ndjeshëm ndaj aromave dhe kimikateve specifike. Kjo teknologji ka potencialin të zbulojë substanca të rrezikshme si eksplozivë, droga apo edhe sëmundje si kanceri. Megjithatë, për momentin, ajo është më afër një “çipi për nuhatje” sesa një superkompjuter i mirëfilltë.



Gazeta "Ushtria" - në shërbim të vlerave kombëtare, dinjitetit dhe paqes.

Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën “Ushtria” janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.





Shtoji Shqipërisë një yll

